


1 | 2020

# FORUM

FORUM ZA ETNIČKE ODNOSI | FORUM FOR ETHNIC RELATIONS

*Policy Paper*

**AVANCIMI BASHKËPUNIMIT TË  
KOMUNITETEVE AFARISTE TË  
SERBIË DHE KOSOVËS:  
RAPORTI DHE REKOMANDIMET**





AVANCIMII  
BASHKËPUNIMIT TË  
KOMUNITETEVE AFARISTE  
TË SERBISË DHE KOSOVËS:  
RAPORTI DHE  
REKOMANDIMET

**PROJEKTI:**  
**PËRFSHIRJA E KOMUNITETIT AFARIST TË SERBISË DHE KOSOVËS  
NË DIALOG TË CILËN E NDËRMJETËSON BASHKIMI EVROPIAN**



FORUM ZA ETNIČKE ODNOSI  
FORUM FOR ETHNIC RELATIONS

Beograd, Prishtinë, tetor 2020

# AVANCIMI BASHKËPUNIMIT TË KOMUNITETEVE AFARISTE TË SERBISË DHE KOSOVËS: RAPORTI DHE REKOMANDIMET

Beograd, Prishtinë, tetor 2020



FORUM ZA ETNIČKE ODNOSI  
FORUM FOR ETHNIC RELATIONS

Kraljice Natalije 45/VII  
11000 Beograd, Srbija  
+381 11 36 20 781  
forumbgd@gmail.com • www.fer.org.rs

CIP - Каталогизација у публикацији  
Народна библиотека Србије, Београд

339.92(497.11:397.115)  
338.1(497.115)  
316.42(497.115)  
316.42(497.11)  
338.1(497.11)

**AVANCIMI bashkëpunimit të komuniteteve afariste të Serbisë dhe Kosovës** : raporti dhe rekomandimet / [kryeredaktor Nenad Đurđević ; përkthimi Shpend Jedrashi]. - Beograd : Forum za etničke odnose, 2020 (Beograd : Dosije studio). - 59 str. ; 24 cm

Na nasl. str. Projekti: Përfshirja e komunitetit afarist të Serbisë dhe Kosovës në dialog të cilën e ndërmjetëson Bashkimi Evropian. - Tiraž 40. - Napomene i bibliografske reference uz tekst.

ISBN 978-86-920703-3-4

а) Друштвено-економски развој -- Косово б) Друштвено-економски развој -- Србија в) Регионална сарадња -- Србија -- Косово

COBISS.SR-ID 24055305

## **FORUM Policy Paper**

*Publikuesi*

Forum za etničke odnose, Beograd

*Kryeredaktor*

Nenad Đurđević

*Përkthimi*

Shpend Jedrashi

*Prepress*

Atelje, Beograd

*Printimi*

Dosije studio, Beograd

Tirazhi: 40

*Viti i publikimit*

2020

ISBN 978-86-920703-3-4

# Përmbajtja

<b>Akronimet dhe shkurtesat .....</b>	<b>5</b>
<b>Hyrje .....</b>	<b>7</b>
<b>I Konteksti dhe sfidat e bashkëpunimit afarist midis Serbisë dhe Kosovës .....</b>	<b>9</b>
<b>II Profili social – ekonomik i Serbisë .....</b>	<b>13</b>
Konteksti makroekonomik .....	13
Ambienti i afarizmit .....	14
Struktura sektoriale e ekonomisë .....	15
Ndërlidhja dhe infrastruktura .....	16
Konteksti shoqëror .....	17
<b>II Profili social – ekonomik i Kosovës .....</b>	<b>19</b>
Konteksti makroekonomik .....	19
Ambienti i biznesit .....	21
Struktura sektoriale e ekonomisë .....	22
Lidhshmëria e infrastrukturës .....	23
Konteksti shoqëror .....	24
<b>IV Ndërvarësia e procesit të hyrjes në be dhe normalizimit të marrëdhënieve të Serbisë dhe Kosovës .....</b>	<b>29</b>
<b>V Konteksti rajonal dhe dinamika .....</b>	<b>35</b>

<b>VI Bashkëpunimi rajonal .....</b>	<b>39</b>
Statusi i implementimit – shtrirjet dhe kufizimet .....	45
Të kuptuarit e sfidave të implementimit.....	47
<b>VII Rekomandimet .....</b>	<b>51</b>
Rekomandimet nga fusha e bashkëpunimit rajonal .....	52
<i>Masat me prioritet.....</i>	<i>52</i>
<i>Masat teknike dhe operative në kuadër të marrëveshjes CEFTA .....</i>	<i>53</i>
<i>Masat teknike dhe operative në kuadër të Procesit të Berlinit.....</i>	<i>54</i>
<i>Masat tjera.....</i>	<i>54</i>
Rekomandimet në fushën e normalizimit të marrëdhënieve midis Serbisë dhe Kosovës .....	55
<i>Masat me prioritet.....</i>	<i>55</i>
<i>Masat teknike dhe operative .....</i>	<i>57</i>
Rekomandimet të cilat veçanërisht kanë të bëjnë me Kosovën.....	58
Rekomandimet të cilat veçanërisht kanë të bëjnë me Serbinë .....	59

# Akronimet dhe shkurtesat

AEO	Operatori i autorizuar ekonomik
BPV	Bruto produkti vendor
CEFTA	
BERZH	Banka Evropiane e Zhvillimit
RRES	Rrjeti Elektrik i Serbisë
BE	Bashkimi Evropian
EUR	Euro
INDEP	Instituti për Politikat Zhvillimore
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
KOSTT	Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës
MAP-REA	Plani disavjeçar i veprimit për krijimin e tregut ekonomik rajonal
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
BPS	Banka Popullore e Serbisë
NPAA	Programi kombëtar për miratimin e trashëgimive juridike të BE-së
NPISAA	Programi kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocijimit
OEK	Oda Ekonomike e Kosovës
OEK	Oda Ekonomike e Serbisë
REA	Hapësira rajonale ekonomike
RCC	Këshilli Rajonal për Bashkëpunim
RIRA	Agjenda rajonale e reformave për investime
ERS	Enti Republikan i Serbisë për Statistika
RYCO	Zyra rajonale për bashkëpunim të rinjve
IDH	Investimet direkte të huaja
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asocijimit

UN	Organizata e Kombeve të Bashkuara
UNMIK	Misioni i Përkohshëm i KB për Kosovën, i themeluar në bazë të Rezolutës së Këshillit të sigurimit nr. 1244
USD	Dollari amerikan
BP6	Balkani Perëndimor i gjashtëshes
WB6 CIF	Forumi i Odës së Investimeve për Ballkanin Perëndimor 6



# Hyrje

Ky raport është rezultati i punës në Projektin Përfshirja e komuniteteve afariste të Serbisë dhe Kosovës në dialog me të cilin ndërmjetëson Bashkimi Evropian të cilin e ka realizuar Forumi për Marrëdhënie Etnike në bashkëpunim me Odën Ekonomike të Serbisë, Odën Ekonomike të Kosovës dhe Instituti për Politikën Zhvillimore. Në kuadër të projektit, gjatë viteve 2019/2020 është zhvilluar një studim kërkimor multidisiplinar në Serbi dhe Kosovë mbi shkallën e njohurive dhe të informimit të komuniteteve të biznesit në Serbi dhe Kosovë në lidhje me dialogun e lehtësuar nga Bashkimi Evropian. Gjetjet e hulumtimit u përdorën edhe për përgatitjen e këtij raporti. Raporti mbi këtë studim është i qasshëm në web faqen e Forumit për Marrëdhëniet Etnike ([www.fer.org.rs](http://www.fer.org.rs)).

Qëllimi i raportit është të tregojë sfidat themelore të cilat pengojnë normalizimin e marrëdhënieve midis Beogradit dhe Prishtinës, si dhe rastet dhe mundësitë që mund të vlerësohen përmes bashkëpunimit më të fortë të komuniteteve të biznesit dhe marrjes në konsideratë të iniciativave rajonale, si një kornizë e mundshme për inkurajimin e procesit të normalizimit. Shqyrtohet konteksti më i gjerë socio-ekonomik në të cilin realizohet bashkëpunimi i njerëzve dhe komuniteteve afariste, me një fokus të veçantë në procesin e avancimit të normalizimit të marrëdhënieve midis Serbisë dhe Kosovës i cili po kryhet nën përkujdesjen e BE-së (Dialogu i Brukselit), procesit të integritit të Serbisë dhe Kosovës në BE dhe mundësive të cilat i ofrojnë iniciativat rajonale. Në këtë dritë, Dialogu i Brukselit dhe iniciativat rajonale shërbejnë si një kornizë shpjeguese në të cilën shihet efektiviteti i masave të ndryshme që kanë reflektime të rëndësishme në të tashmen politike dhe ekonomike të këtyre ekonomive.

Në bazë të analizës së efekteve të gjertanishme në procesin e normalizimit të marrëdhënieve midis Serbisë dhe Kosovës dhe të sfidave të cilat janë në rruqen e zhvillimit më intensiv të bashkëpunimit të tyre të ndërsjellë ekonomik, argumentohet se përpjekjet e gjertanishme nuk kanë ndihmuar në mënyrë thelbësore stabilitetin politik, ekonomik dhe shoqëror të këtyre ekonomive e që është qëllimi bazik dhe vlera politike e integritimeve evropiane. Konform

kësaj, propozohet të merren parasysh dhe afirmohen modalitetet për dinamizimin e bashkëpunimit të përgjithshëm ekonomik dhe tregtar, me qëllim të:

- Largimit të barrierave të cilat pengojnë bashkëpunimin e komuniteteve të biznesit, dhe me këtë edhe normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës në fushën e zhvillimit të marrëdhënieve të qëndrueshme ekonomike;
- Përmirësimit të komunikimit ndërmjet njerëzve afarist dhe institucioneve kompetente me qëllim të avancimit të bashkëpunimit tregtar midis njerëzve dhe komuniteteve afariste nga Serbia dhe Kosova;
- Përmirësimit të mjedisit të biznesit dhe bashkëpunimit ekonomik të njerëzve dhe komuniteteve afariste nga Serbia dhe Kosova, duke u mbështetur në arritjet dhe potencialet e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve midis Beogradit dhe Prishtinës, të mbështetur nga BE.

Raporti është dedikuar për njerëzit dhe komunitetet afariste, institucionet kompetente (qeveritë, autoritetet lokale, organizatat ndërkombëtare), shoqatat ndërkombëtare të biznesit, si dhe për profesionistët e interesuar dhe publikun e gjerë.

Udhëheqësi i projektit: Dr Dušan Janjić.

Autorë të raportit: Dr. Dušan Janjić dhe Burim Ejupi.

Hulumtuesit: Dardan Abazi, Katarina Antić, Dina Kandić, Dr Dušan Lopandić, dr Nada Raduški i dr Danilo Šuković.

Ekipi redaktues: Miomir Brkić, Nenad Đurđević.

Me hulumtime shtesë, si dhe me komentet e tyre kanë dhënë kontribut të konsiderueshëm për përmirësimin e tekstit të raportit bashkëpunëtorët e OES Bojan Stanić dhe Aleksandar Radovanović si dhe Dr. Alban Hashani, drejtor ekzekutiv i Riinvestit.

Në këtë analizë janë përdorur termet me kuptime si në vijim:

- “Kosova” në kuptimin i cili është definuar me Marrëveshjen e Brukselit, gjegjësisht pa prejjudikim të statusit në përputhje me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara nr. 1244 dhe “me Mendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë mbi deklaratën për pavarësinë e Kosovës”.
- “Veriu i Kosovës” tregon zonën e dominuar me popullatë serbe e cila gjendet në veri të lumit Ibër dhe e përbëjnë komunitatet: Zubin Potok, Leposaviq, Zvečan, dhe Mitrovica e Veriut. Ky kuptim nuk është identik me emërtimin i cili është në përdorim zyrtar në Kosovë dhe i cili tregon një zonë më të gjerë të cilën e përbëjnë, përveç komunave të lartë përmendura, edhe komunitatet që gjenden në jug të lumit Ibër të dominuar me popullatë shqiptare dhe këto janë: Mitrovica, Skenderaj dhe Vushtrria.
- “Dialogu i Brukselit” tregon dialogun, gjegjësisht negociatat dhe marrëveshjet mbi normalizimin e marrëdhënieve në mes të Serbisë dhe Kosovës i cili po zhvillohet me përkrahjen e BE-së, Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të KB 64/298, të muajit mars 2011.

# I Konteksti dhe sfidat e bashkëpunimit afarist midis Serbisë dhe Kosovës

Marrëdhëniet ekonomike midis Serbisë dhe Kosovës kanë një histori të gjatë të zhvillimit të çekuilibruar. Në gjysmën e dytë të shekullit të 20-të, Kosova në mënyrë politike dhe administrative kishte statusin e një krahine autonome brenda Republikës së Serbisë. Kjo zonë ishte e pazhvilluar ekonomikisht dhe me një infrastrukturë të pazhvilluar. Edhe pse në periudhën 1950-1980, është arritur një zhvillimi i fortë ekonomik, Kosova ka mbetur njësi më e pazhvilluar brenda ish-Jugosllavisë. Marrëdhëniet e tyre politike dhe ekonomike bashkëkohore ishin përcaktuar në mënyrë thelbësore nga trashëgimia e përgjithshme në të cilën ngjarjet të cilat ndodhën në fund të shekullit të kaluar kanë një vend vendimtar.

Shikuar në përgjithësi, marrëdhëniet midis Serbisë dhe Kosovës janë jashtëzakonisht komplekse dhe gjatë tri dekadave të fundit kanë qenë në rënie rapide, duke arritur kulmin me luftën e vitit 1999, gjegjësisht shkëputjen e plotë të marrëdhënieve pas shpalljes së njëanshme të pavarësisë së Kosovës në vitin 2008. Kjo periudhë është në të njëjtën kohë një nga periudhat më të trazuar në historinë politike të Serbisë dhe Kosovës, të shënuar me fundin e socializmit dhe shpërbërjen e Jugosllavisë, e cila mori edhe karakteristikat e konflikteve ndëretnike, dhe në Kosovë një formë të represionit ushtarako-politor dhe aktiviteteve të armatosura të autoriteteve serbe dhe formacioneve të armatosura të shqiptarëve të Kosovës. Kjo periudhë u shënuar me krijimin e shteteve të reja, me izolimin dhjetëvjeçar ndërkombëtar për shkak të sanksioneve të BE-së dhe OKB-së, dhe me ndërhyrjen ushtarake të NATO-s (1999). Megjithëse

proceset e transformimit dhe rindërtimit institucional dhe strukturor filluan në vitin 2000, të dy palët vazhdojnë të ballafaqohen me barrën e trashëgimisë së përgjithshme historike dhe ekonomike dhe tranzicionit jo të plotë.

Sfida kryesore me të cilën përballen këto ekonomi ishte përkeqësimi i situatës ekonomike dhe rënia e thellë e aktivitetit ekonomik, me një mungesë të dukshme të kapaciteteve për një kalim paqësor dhe efikas nga një ekonomi e planifikuar, socialiste në ekonomi të tregut. Shkalla e pamjaftueshme e rritjes ekonomike, papunësia e lartë, jo konkurrenca, infrastruktura e pazhvilluar, privatizimi i pasuksesshëm i ndërmarrjeve në pronësi shoqërore kanë ndikuar që Serbia dhe Kosova ende të mbeten prapa në nivelin të zhvillimit ekonomik, konkurrencës së përgjithshme dhe në nivelin e standardeve të jetesës prapa vendeve të zhvilluara anëtare të BE-së.

Në dritën e një situatë të tillë ekonomike, dhe për shkak të domosdoshmërisë së zbatimit të reformave të domosdoshme dhe hapjes së rrugës për integrimin evropian, filloi një dialog teknik midis Beogradit dhe Prishtinës, i cili në tetor të vitit 2012 u shndërrua në negociata politike për normalizimin e marrëdhënieve, kryesisht për të lehtësuar dhe përmirësuar jetën e përditshme të qytetarëve të Serbisë dhe Kosovës. Nënshkrimi i Marrëveshjes së Brukselit në prill të vitit 2013 paraqet një ndryshim fundamental në marrëdhëniet midis dy palëve. Përkundër përparimit të caktuar të realizuar në procesin e normalizimit të marrëdhënieve, zbatimi i kësaj marrëveshje në mënyrë të konsiderueshme mbetet prapa dhe pengon bashkëpunimin më të thellë dhe më domethënës ekonomik midis komuniteteve të biznesit të Serbisë dhe Kosovës.

Me gjithë ngecjet në zbatim e madje edhe moszbatimit të asaj për çka është marrë vesh dhe marrëdhënieve politike jashtëzakonisht të ndërlikuara midis Serbisë dhe Kosovës, rrjedhat ekonomike patën, në periudhën prej vitit 2000 deri në fund të vitit 2018, një fluks në rritje që arriti një maksimum në vitin 2017 dhe ishte 464,1 milion euro<sup>1</sup>. Kjo padyshim tregon që ekziston një potencial dhe hapësirë e madhe për dinamizmin e bashkëpunimit të tyre ekonomik në kushtet e konvergencës më të madhe të tregut, mjedisit të avancuar të biznesit, forcimit të konkurrencës dhe përmirësimit të infrastrukturës.

Përveç kësaj, përfshirja e Serbisë dhe Kosovës në nisma të shumta rajonale për të inkurajuar bashkëpunimin hap një hapësirë për forcimin e bashkëpunimit dhe ndërtimin e një fryme partneriteti që mbështet dhe realizon potencialin ekonomik të Serbisë dhe Kosovës. Forcimi i marrëdhënieve ekonomike në bazë të lëvizjes së lirë të mallrave, shërbimeve, njerëzve dhe kapitalit vepron si një katalizator jetik në lirin e forcave prodhuese dhe realizimin e potencialit të tyre. Situata ekzistuese dhe sfidat me të cilat përballen këto dy ekonomi

<sup>1</sup> Sipas të dhënave të OES, Serbia ka eksportuar në Kosovë mallra në vlerë prej 442,3 milionë euro, ndërsa Kosova në Serbi ka eksportuar mallra në vlerë prej 21,8 milionë euro. Kjo tregon se ka ekzistuar një suficit i madh në anën e Serbisë në marrëdhëniet tregtare me Kosovën.

tregojnë se nismat rajonale ende nuk sjellin përparim domethënës në këtë drejtim. Të kuptuarit e shkaqeve, bartësve dhe pasojave të barrierave në rrugën e ritmit të plotë të bashkëpunimit rajonal dhe heqja e tyre është një supozim i domosdoshëm për përmirësimin e bashkëpunimit tregtar dhe lidhjes së komuniteteve të biznesit nga Serbia dhe Kosova.



## II Profili social – ekonomik i Serbisë

Në kuptimin ekonomik, Republika e Serbisë i takon një grupi të vendeve që janë në tranzicion dhe në proces të hyrjes në Bashkimin Evropian, gjë që paraqet një katalizator kryesor të reformave. Serbia ka fituar statusin e vendit kandidat për anëtarësim në BE në mars të vitit 2012 derisa negociatat për anëtarësim kanë filluar në janar të vitit 2014. Si një vend i mëparshëm i sistemit socialist, transformimi i saj në ekonomi të tregut po zgjatë një kohë jashtëzakonisht të gjatë, dhe dinamika e tranzicionit përcaktohet kryesisht nga veprimi i një numri faktorësh politikë.

Përbërja etnike e popullatës së Republikës së Serbisë është i shumëllojshëm, gjë që është rezultat i ngjarjeve dinamike gjatë historisë në këto hapësira. Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë (pa të dhëna për Kosovën) të vitit 2011, Serbia ka gjithsej 7,2 milionë banorë prej të cilëve serbët, si popull shumicë janë 6 milionë (83,3 %)<sup>2</sup>.

### Konteksti makroekonomik

Në aspektin e indikatorëve kryesor, korniza makroekonomike e Serbisë është stabile. Në vitet 2018 dhe 2019, ekonomia e Serbisë hynë në fazën e ekspansionit me shkallën e realizuar të rritjes së BPV prej 4,4 % dhe 4,2 %. Në *strukturën e*

2 Sa i përket madhësisë, pakicat më të rëndësishme kombëtare janë hungarezët (253.900 ose 3.5 përqind), romët (147.600 ose 2.1 përqind) dhe boshnjakët (145.300 ose 2.0 përqind), ndërsa të tjerët marrin pjesë nën 1 përqind, veçanërisht kroatët (57.900 ose 0.8 përqind), Sllovake (52.800 ose 0.7 përqind), malazezë (38.500 ose 0.5 përqind), vllah (35.300) ose 0.5 përqind) dhe të tjerët. (Regjistrimi i Popullsisë, Familjeve dhe Banesave në Republikën e Serbisë, SORS, Libri 1, 2012).

BPV-së të vitit 2018 pjesëmarrje më të madhe ka pasur industria përpunuese, me pjesëmarrje prej 14,5 %, pastaj tregtia me shumicë dhe pakicë dhe riparimi i veturave me 11,5 %, biznesi me patundshmëri me 7 %, pastaj sektori i bujqësisë, pylltarisë dhe peshkatarisë me 6,3 %. Në anën e shfrytëzimit të BPV-së pjesëmarrje më të madhe kanë pasur shpenzimet për konsumim personal të ekonomive familjare me pjesëmarrje prej 67 %, derisa bruto investimi në mjete themelore ka marrë pjesë me 22,4 %. BPV për kokë banori në vitin 2018 është 6.137 euro, me rritje të prishme për vitin 2019 (6.575 euro).

Në aspektin e *aktiviteteve të tregtisë së jashtme*, Serbia ka deficit të lartë të theksuar. Eksporti i përgjithshëm i mallrave në vitin 2019 ishte 17,5 miliardë euro (rritje prej 7,7 % në krahasim me vitin 2018), derisa deficit i shkëmbimit të mallrave ishte 6,3 miliardë euro (rritje prej 12,5 % në raport me vitin 2018). Partnerë kryesor të Serbisë në tregti të jashtme janë vendet e Euro Zonës, në radhë të parë Gjermania dhe Italia, pastaj pasojnë vendet e rajonit (Bosnja dhe Hercegovina dhe Mali i Zi), Rusia dhe Kina.

*Inflacioni* është i ulët dhe i parashikueshëm, mesatarisht lëviz rreth 2 % në nivelin vjetor. *Kursi devizor* (dinari ndaj euros) është stabil<sup>3</sup>, e që bazohet në rrjedhën e devizave nga bota e jashtme nëpërmes të investimeve në letra shtetërore me vlerë (ardhja e turistëve të huaj dhe remitencave të cilat po i dërgon diaspora e cila është me punë të përhershme apo të përkohshme në botën e jashtme. *Borxhi publik* në raport me BPV ka rënë në rreth 52 %, e që është nën “Kriteret e Maastrikst-it” i cili është 60 % të BPV-së.

Sipas punësimit të regjistruar (tremujori i parë i vitit 2020), Serbia ka rreth 2.2 milionë punëtorë, derisa *shkalla e papunësisë* ishte 9,7 %. Rënia e papunësisë është pasojë e krijimit të vendeve të reja të punës me zgjerimin e kapaciteteve shërbyese dhe prodhuese, me pjesëmarrje domethënëse të investimeve në fuqi punëtore (gjë që ishte edhe politika qëllimore e Qeverisë, në mënyrë që të zvogëlohet papunësia, e cila në vitin 2012 ishte afër 24 %).

## Ambienti i afarizmit

Sipas Raportit të Bankës Botërore mbi *kushtet e afarizmit* për vitin 2020 (“Doing Business Report”), Serbia ka marrë vendin e 44, gjegjësisht ka përparuar për katër pozita në krahasim me raportin për vitin 2019. Pozicioni më i mirë është arritur për shkak të marrjes më të lehtë të lejes së ndërtimit, zvogëlimit

<sup>3</sup> Vlera mesatare EUR/RSD ishte 118,27 në vitin 2018, gjegjësisht 117,85 në vitin 2019. Në katër muajt e vitit 2020 kursi është gati i fiksuar në 117,57 dinarë për një euro, gjë që tregon një ngritje të lehtë të vlerës, në disa vitet e fundit.



të taksave administrative dhe përmirësimit të besueshmërisë në furnizim me energji elektrike. Fusha më problematike ka të bëjë me fillimin e një biznesi për shkak të mënyrës së vendosjes të procedurës, e cila duhet të jetë në funksion të parandalimit të pastrimit të parave - regjistrimit të pronarëve të vërtetë.

Ambienti për investim po avancohet dhe *aktiviteti i investimeve* në Serbi po rritet nga viti në vit. Vetëm në vitin 2019 derdhja e përgjithshme e investimeve direkte të huaja (IDH) ishte 3,8 miliardë euro, kryesisht nga vendet e BE-së (afro 60 % të IDH të përgjithshme).

Një prej sfidave të rëndësishme për rritje të qëndrueshme ekonomike paraqet ekonomia joformale, gjegjësisht punësimi dhe afarizmi joformal. Vlerësohet se ekonomia joformale është në nivelin prej 25 - 30 % të BPV-së. Gjithashtu, është me rëndësi se shkalla e zhvillimit të ekonomisë joformale është në korrelacion me dobësitë e institucioneve, sidomos me mungesë të transparencës dhe përhapjes së korrupsionit.

Sipas Indeksit të *Perceptcionit të Korrupsionit* të organizatës ndërkombëtare “Transparency International”, në të cilin janë renditur 180 vende, Serbia në vitin 2019 është renditur në vendin e 91 (me 39 pikë) dhe është klasifikuar në vendet me korrupsion të përhapur. “Transparency International” në raportin e tij ka konstatuar se vet qeveria e Republikës së Serbisë, haptas i shkel dhe i relativizon rregullat kundër korrupsionit të cilat i ka vendosur vet ndërsa Prokuroria nuk jep përgjigje të qarta në dyshimet e paraqitura publikisht dhe të dokumentuara për korrupsion. Përveç kësaj, problem serioz paraqet edhe transparencja e pamjaftueshme e organeve shtetërore dhe suspendimi i mekanizmave për luftë kundër korrupsionit gjatë kontraktimit të projekteve më të mëdha infrastrukturore.

## Struktura sektoriale e ekonomisë

Në kuadër të industrisë së përpunimit e cila ka pjesëmarrje më të madhe në strukturën e BPV-së më të përfaqësuara janë industria metalike, kimike, ushqimore dhe e tekstilit. Në fushën e industrisë së prodhimit dominon prodhimi i pjesëve dhe komponentëve të prodhimit, gjegjësisht përpunimi primar dhe industria me fuqiintensive punëtore, prodhimet finale të cilëve janë të nivelit të ulët të përpunimit teknologjik dhe me një vlerë modeste të shtuar.

Edhe pse Serbia shihet si një vend tradicionalisht bujqësor, lidhja në mes të bazës së resorit dhe industrisë ushqimore nuk është aq efiçente. Struktura e prodhimit bujqësor në vitin 2018 ka përfshirë prodhimin e bimëve (bujqësinë, pemëtarinë dhe vreshtarinë) e cila ka shënuar një rritje prej 114,3 % në krahasim me vitin 2017, dhe blegtorinë (gjedhet, derrat, delet dhe shpendët) e cila ka shënuar një rritje prej 101,3 % në krahasim me vitin 2017.

*Industria ndërtimore* shënon rritje stabile për shkak të intensivimit të ndërtimit të objekteve banesore dhe afariste si dhe të infrastrukturës së trafikut. Vlera e përgjithshme e punëve të kryera ndërtimore në vitin 2018 ishte rreth 2,9 miliardë euro dhe ishte rritur për 42 % në krahasim me vitin 2015<sup>4</sup>.

*Turizmi* në Serbi është në zhvillim të përshpejtuar por po rritet dhe numri i turistëve të cilët po e vizitojnë Serbinë si dhe oferta e kapaciteteve turistike. Turizmi në vitin 2018 është rritur për 35 % në krahasim me vitin 2014 (me fitim prej rreth 742 milionë euro)<sup>5</sup>.

*Sektori energjetik* është jashtëzakonisht i varur nga importi i burimeve të energjisë (naftës dhe gazit natyror). Serbia në vitin 2008 ka vendosur që një pjesë të sektorit energjetik – prodhimin e naftës, derivateve të naftës dhe gazit – ndërmarrjen “Industria e Naftës së Serbisë” t’ia shesë kompanisë ruse “Gaspromnjetf” i cili është monopolist në tregun e Serbisë. Në dallim prej sektorit të naftës, Serbia a ka mbajtur në pronësi shtetërore prodhimin e *energjisë elektrike* (të bashkuar në kompaninë Elektro-ekonomia e Serbisë). Në kuadër të kësaj kompanie veprojnë minierat e thëngjillit në Vreoc dhe Kostollac, termocentralet në Obrenovac, Kostollac, Svillajnac dhe në Vreoc dhe hidrocentralet në Gjerdap dhe Bajina Bashta. Edhe pse e ka miratuar strategjinë e zhvillimit të energjisë së ripërtëritshme (mini hidrocentralet, energjia solare, parqet e erës, biomasa, ato termale), Serbia deri tani nuk ka bërë ndonjë ndryshim më domethënës në strukturën e prodhimit të energjisë. Në aspektin e *prodhimit të minierave dhe sektorit të lëndëve të mineraleve*, Serbia ka 16 miniera aktive, ndërsa xehetaria parqet një bazë të konsiderueshme në zhvillimin e industrisë. Thëngjilli me kalori të ulët (linjiti), i cili nxirret nëpër mihje sipërfaqësore në Kollubara dhe Kostollac, jep 65 % të energjisë elektrike në Serbi.

## Ndërlidhja dhe infrastruktura

*Përsa i përket infrastrukturës*, Serbia është një korridor i rëndësishëm evropian. Për këtë dëshmojnë edhe 89 kalime kufitare për trafik ndërkombëtar dhe kufitar ndaj vendeve fqinje. Nëpër territor të Serbisë kalojnë “arteret kryesore” të trafikut rrugor, hekurudhor, të lumenjve dhe ajror të cilat e lidhin kontinentin e Evropës me Lindjen e Mesme dhe të Afërt.

Serbia, në trafikun hekurudhor, është pjesë e projektit botëror “Brezi dhe rruga”, të cilin prej vitit 2012 e realizon Republika Popullore e Kinës. Bëhet fjalë

4 Vlera e punëve ndërtimore të kryer në dinarë: 344.670.414.000 të konvertuar në euro sipas kursit të mesëm zyrtar, kur janë përditësuar të dhënat.

5 Vlera në dinarë është 87.687.000.000 dhe është konvertuar sipas kursit të mesëm zyrtar të dinarit.

për ndërtimin e hekurudhës për shpejtësi të mëdha i cili e lidh Selanikun dhe Budapestin. Përndryshe, infrastruktura hekurudhore në Serbi është e lënë pas dore dhe është pak e zhvilluar<sup>6</sup>. Me ndihmën e fondeve dhe bankave evropiane dhe me ndihmën e shtetit të Federatës Ruse, është në vazhdim e sipër rekonstruktimi dhe modernizimi i hekurudhës Beograd-Nish.

Nëpër Serbikalon edhe korridori rrugor evropian 10 në të cilin mbështeten edhe dy autostrada / E75 (Zagreb-Beograd) dhe Korridori 11 (Beograd-Tivar). Në zhvillim e sipër janë edhe përgatitjet për ndërtimin e autostradës Nish-Prishtinë dhe më tutje që lidhet me Durrësin e cila do të hapë edhe një dalje në Detin Adriatik.

Nëpër Serbi kalon lumi i dytë më i madh evropian, Danubi (588 kilometra) dhe dy lumenj tjerë të mëdhenj (Tisa me gjatësi prej 168 kilometrave dhe Sava e gjatë 206 kilometra). Këto lumenj janë lundruar dhe në to ekziston trafiku ndërkombëtar. Në 23 porte lumenjsh, ngarkohen 8.515.265 tonë mallra të ndryshme dedhëse (në thasë) në vit. Serbia është një nyje e rëndësishme në trafikun ajror. Aeroporti “Nikolla Tesla” në Beograd u shndërrua në një qendër të rëndësishme rajonale.

Në pjesën e infrastrukturës së telekomunikacionit, në Serbi në vitin 2018 ishin regjistruar 38 operatorë. Në tregun e telefonisë mobile kanë punuar 3 rrjetë të operatorëve, dhe 81 operatorë janë regjistruar për shërbime të distribucionit me përmbajtje mediatike. Në BPV-në e Serbisë, të hyrat nga komunikimet elektronike kanë pasur pjesëmarrje prej 3,9 %. Pjesa më e madhe e të hyrave është realizuar nga ofrimi i shërbimeve të telefonisë mobile (58,2 % apo rreth 978 milionë euro). Në aspektin e sektorit mediatik, ndryshimet strukturore ende nuk janë zbatuar deri në fund, ndërsa tregu është i ngopur në mënyrë të konsiderueshme në raport me shumicën, me 2.500 medie të regjistruara.

## Konteksti shoqëror

Lëvizjet demografike dhe gjendja në tregun e punës janë në shenjën e trendëve negative siç janë: plakja e popullatës, mungesa e fuqisë së kualifikuar punëtore, me dyndje të lartë të ekspertëve dhe fuqisë së kualifikuar punëtore.

Tregu i punës relativisht funksionon, mirëpo oferta dhe kërkesa e fuqisë punëtore tregon se ai nuk është stabil dhe i balancuar. Nga njëra anë, është i theksuar deficitin në ofertën e ekspertëve të kualifikimit të lartë të profileve të ndryshme (IT ekspertët, mjekët), ndërsa nga ana tjetër në ofertë dominon

6 Prej 3.735 kilometrave të hekurudhës, vetëm 1.272 kilometra janë me lidhje elektrike dhe 288 kilometra janë me dy binarë.

fuqia punëtore e arsimimit të ulët (77,9 për qind kanë arsimim të ulët apo të mesëm). *Fitimet mesatare neto* në Serbi janë rreth 510 euro, derisa fitimet mediale janë 380 euro, që do të thotë se 50 % të të punësuarve fitojnë nën këtë nivel. Fitimi minimal neto është 30.000 dinarë (rreth 255 euro). Në Serbi, në vitin 2019 ka pasur 5.923.900 banorë më të vjetër se 15 e më tepër vjeç. Prej këtij numri 3.236.900 kanë qenë aktivë, 2.901.267 të punësuar, 506.865 të papunë dhe 2.687.000 banorë joaktivë.

Serbinë e karakterizojnë ndryshimet e mëdha në *strukturën e pleqërisë* dhe procesi i përsheptuar i plakjes së popullatës të shkaktuar në rend të parë me rënien shumëvjeçare të shkallës së fertilitetit. Regjistrimi i popullsisë nga viti 2011, konfirmon plakjen e popullatës së Serbisë e cila ka 1,3 milion (17,4%) persona mbi 65 vjeç, dhe 1 milion (14,3%) të rinj (0-14 vjeç). Indeksi i plakjes është 1,22, ndërsa moshë mesatare është 42,2 vjeç. Kjo e renditë Serbinë në vendet me popullatë të vjetër të theksuar. Me këtë Serbia është e ballafaquar me de-popullimin brengosës. Numri i vlerësuar i banorëve nga ERS në vitin 2018 është 6,9 milionë, dhe që në krahasim me Regjistrimin e vitit 2011 është zvogëlim për rreth 300.000. Vetëm në bazë të shkallës negative të shtimit natyral (-5,4 promilë), Serbia humb 38.000 banorë në vit.

*Emigrimi* i popullatës është njësoj i rëndësishëm dhe problem i madh. Sipas të dhënave të OECD, rreth 50.000 persona në vit e braktisin Serbinë, derisa të dhënat e Agjencisë Evropiane për Statistika tregojnë se 52.049 persona në vit shkojnë nga vendi. Kjo ka pasoja afatgjata negative në zhvillimin e përgjithshëm të Serbisë.

Shkalla e rrezikut nga *varfëria*<sup>7</sup> në vitin 2018 ishte 24,3 %, dhe është më e ulët në krahasim me vitin 2017. Shikuar kah moshë, personat e moshës prej 18 deri 24 vjeç ishin më së shumti të ekspozuar ndaj rrezikut nga varfëria (29,1%), si dhe personat më të rinj se 18 vjeç (28,8%). Shkallën më të ulët të rrezikut nga varfëria kanë pasur personat më të vjetër se 65 vjeç (21,1%). Varësisht nga statusi i punësimit, te personat e moshës 18 dhe më të vjetër, më të ekspozuar në rrezik nga varfëria ishin personat e papunë (49%), derisa shkalla më e ulët e rrezikut nga varfëria është te të punësuarit (6,8%).

7 Pragu i rrezikut nga varfëria ka qenë mesatarisht 16.615 RSD për ekonomi familjare njëanëtaresh. Për ekonomi familjare me dy të rritur dhe një fëmijë të moshës deri 14 vjeç, pragu i rrezikut nga varfëria ishte 29.907 RSD derisa për një ekonomi familjare katëranëtaresh ( me dy të rritur dhe dy fëmijë të moshës deri 14 vjeç) ky prag ishte 34.892 RSD.

## II Profili social – ekonomik i Kosovës

Kosova gjendet në procesin e tranzicionit ekonomik dhe është duke u ballafaquar me shumë sfida të rritjes ekonomike. Dobësitë strukturore në masë të madhe po e pengojnë ekonominë e Kosovës, ku mbizotërojnë vlerat e ulëta të situara industriale me BPV më të ulët për kokë banori midis vendeve të Ballkanit Perëndimor. Përpjekjet për t'u afruar BE-së janë leva kryesore për reforma. Kosova në tetor të 2015-ës e ka nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizim Asocijimit me BE-në. Integrimi i Kosovës në tregjet rajonale po ngecë, e që po rezultojnë me deficit shumë të lartë të jashtëm dhe me shkallë më të vogël të eksportit në rajon.

Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, Kosova ka 1,78 milionë banorë. Popullata e Kosovës është prej më të rinjve në Evropë me moshë mesatare prej 30,2 vjet. Pjesa më e madhe e të rinjve (10-24 vjeç) jetojnë në zonat rurale (61%) ndërsa në zonat urbane diçka më shumë se 30 %.

### Konteksti makroekonomik

Mjedisi makroekonomik karakterizohet me mungesë të investimit masiv, shkallë të lartë të papunësisë (29,6%) dhe melargimin masiv të popullatës të aftë për punë me forcimin e intensitetit të tregtisë dhe shkëmbimit financiar me botën. Sipas raporteve të Bankës Botërore, BPV real është rritur, dhe në dhjetë vjetet e fundit mesatarisht është rritur për 3,5 %<sup>8</sup>. Në vitin 2019 ishte 7,069, 296,

8 Banka Botërore (2018), në dispozicion në: <https://www.worldbank.org/en/country/kosovo/overview>

059.00 euro. Shërbimet kanë pjesëmarrje më të madhe në *strukturën e BPV-së* (më shumë se 50%), industria 17,5 % dhe bujqësia 8,5 %<sup>9</sup>. BPV sipas qasjes së shpenzimeve, ka shënuar një rritje prej 14,3%; formimi i kapitalit bruto 4.1%; shpenzimet e konsumit final të familjeve dhe institucioneve jofitimprurëse të cilat ofrojnë shërbime ekonomive familjare 0.1%. Rritja e realizuar ekonomike nuk ishte e mjaftueshme për të siguruar vendetë mjaftueshme pune, gjegjësisht për të ulur ndjeshëm nivelin e lartë të papunësisë<sup>10</sup>.

Në shkëmbimin e tregtisë së jashtme Kosova ka deficit të theksuar tregtar, i cili në dhjetor 2019 ishte 12,7 % apo 308,3 milionë euro, ndërsa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar 273,5 milionë euro<sup>11</sup>. Në import marrin pjesë këto grupe të prodhimeve: 14,3 % janë makinat, pajisjet mekanike dhe elektrike, 13 % prodhimet e mineraleve, 1,4 % ushqimi i përpunuar, pijet, duhani, 11,4 % mjetet e transportit, 10,3 % metalet bazike dhe prodhimet e tyre, 7 % prodhimet kimike, 4,8 % prodhimet bimore, 4,8 % plastika, goma dhe prodhimet e tyre<sup>12</sup>.

Në tremujorin e parë të vitit 2019, shkëmbimi i mallrave ka shënuar një rritje prej 8,6 % në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2018. Në tremujorin e dytë të vitit 2019, ekonomia kosovare ka realizuar një rritje reale prej 4,13 % dhe rritje nominale prej 5,73 %<sup>13</sup>. Shkalla reale e rritjes në tremujorin e dytë të vitit 2019 kryesisht i atribuohet investimeve të përgjithshme dhe neto eksportit të mallrave dhe shërbimeve.

Sipas të dhënave të CEID Data, në dhjetor të vitit 2018, shkalla e papunësisë është zvogëluar në 29,6 % në raport me 30,5 % në periudhën e njëjtë të vitit 2017. Ky trend ka vazhduar edhe në tremujorin e tretë të vitit 2019, kur shkalla e papunësisë ka rënë në 24,5 % nga 25,3 % sa ishte në tremujorin e dytë të vitit 2019<sup>14</sup>. Shkaku kryesor i papunësisë është kërkesa e ulët për fuqi punëtore. Në të vërtetë, sektori privat në Kosovë është i dobët, shumica e të punësuarve punojnë në mikro ndërmarrje, në sektorë të cilët nuk kanë shkallën e lartë të vlerës së shtuar, si dhe në punët me kualifikim të ulët.

(accessed on February, 2020)

9 Banka Botërore (2018) në dispozicion në: <https://www.worldbank.org/en/country/kosovo/overview#3> (accessed on February, 2020)

10 CEIS (2018), në dispozicion në: <https://www.ceicdata.com/en/indicator/kosovo/forecast-nominal-gdp-per-capita> (accessed on February, 2020)

11 Agjencia e Statistikave të Kosovës (2019), në dispozicion në: <https://ask.rks-gov.net/en/kosovo-agency-of-statistics/add-news/international-trade-statistics-december-2019>

12 Ibid

13 Agjencia e Statistikave të Kosovës (2019), në dispozicion në: <https://ask.rks-gov.net/en/kosovo-agency-of-statistics/add-news/gross-domestic-product-by-expenditure-and-production-approach-q2-2019>

14 CEIC, në dispozicion në: <https://www.ceicdata.com/en/indicator/kosovo/unemployment-rate>

## Ambienti i biznesit

Procesi i privatizimit është kryer sipas modelit *spin-off*, të cilin, duke u thirrur në Rezolutën 1244 të KS të KB, e ka zbatuar administrata e përkohshme e UNMIK-ut në kuadër të shtyllës së IV të pushtetit të saj – zhvillim ekonomik dhe rindërtimi dhe i cili është nën patronazhin e BE. Privatizimi i zbatuar nuk është një nga praktikat e suksesshme, sepse nuk kontribuoi ndjeshëm në zhvillimin ekonomik si dhe pasi ka lënë pas vetit një numër të madh të çështjeve të pazgjidhura mbi të drejtën e pronës<sup>15</sup>. Më së shumti privatizime ka pasur në periudhën prej vitit 2006 deri 2011, dhe deri në fund të vitit 2019, vlera e pronave të privatizuara ka arritur në 732 milionë euro<sup>16</sup>.

Kosova ka një nivel të ulët investimesh dhe përmirësime të rëndësishme janë të nevojshme për forcimin e *klimes së investimeve*. Ata marrin pjesë në strukturën e investimeve të drejtpërdrejta me rreth 200 milion dollarë, nga të cilat shumica investohen në pasuri të paluajtshme nga investitorë nga diaspora.

Sipas Raportit të Bankës Botërore mbi kushtet e afarizmit për vitin 2020 (“Doing Business Report”), Kosova u rendit në vendin e 57, duke rënë dukshëm në krahasim me vendin e 44 në Raportin për vitin 2019<sup>17</sup>. Megjithëse janë marrë masa të konsiderueshme vitet e fundit për të përmirësuar mjedisin e biznesit, fushat më problematike mbeten korrupsioni, zbatimi i dobët i kontratave dhe të drejtat e paqarta të pronës.

Sipas Indeksit të *Perceptimit të Korrupsionit* të “Transparency International”, i cili mat nivelin e korrupsionit në sektorin publik në 180 shtete të botës, Kosova në vitin 2019 u rendit në vendin e 101 me një indeks prej 36<sup>18</sup>. Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit shprehet nga zero (korrupsioni shumë i përhapur) deri në 100 (pa korrupsion).

15 Shembull: privatizimi të cilin BE si pjesë e UNMIK-ut nuk deshi ta nis, janë kompanitë në Veri të Kosovës duke përfshirë edhe ato të cilat i kanë kompanitë amë në Republikën e Serbisë. Vetëm pas shuarjes së kësaj shtylle të UNMIK-ut, në vitin 2011, autoritetet kosovare kanë miratuar tre ligje: *Ligjin për AKP, ligjin me të cilin rregullohet veprimtaria e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, si dhe Ligjin për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe të aseteve të tyre, i ashtuquajtur Ligji për Trepçën*. Për shkak të rezistencës politike të Beogradit dhe udhëheqjen politike të serbëve në Kosovë këto privatizime nuk janë kryer as deri në ditën e sotme dhe nuk ishin as pjesë e Dialogut të Brukselit.

16 Agjencia Kosovare e Privatizimit, (2019), SOE Sales Report, në dispozicion në: <http://www.pak-ks.org/page.aspx?id=1,37>

17 World Bank Group Flagship Report, Doing Business Training Reform, fq.

18 [https://www.doingbusiness.org/content/dam/doingBusiness/media/Annual-Reports/English/DB2019-report\\_web-version.pdf](https://www.doingbusiness.org/content/dam/doingBusiness/media/Annual-Reports/English/DB2019-report_web-version.pdf)

## Struktura sektoriale e ekonomisë

Në strukturën e BPV të Kosovës, *industria* merr pjesë me 17,5 % ndërsa brenda kësaj *industria e ndërtimit* viteve të fundit është një prej sektorëve më të rëndësishme dhe paraqet potencial shumë të rëndësishëm ekonomik të Kosovës.

Bujqësia merr pjesë në BPV me gjithsej 12,9 %. Prodhimi bujqësor është në masë të madhe i llojit të përzier, prodhohet me metoda të vjetra, tradicionale prandaj është edhe joefikase. Për të kaluar nga prodhimi individual në atë të produktivitetit të lartë, është e nevojshme të investohet në ferma të specializuara, mini-ferma, të cilat posedojnë burime vet qëndrueshme, është e nevojshme të vendoset rrjeti i kontrollit mbrojtës dhe tëveterinarisë si dhe të kërkohen zgjidhje nëpërmes të shoqatave të prodhuesve<sup>19</sup>.

Kosova ka potenciale të rëndësishme për *turizëm* dimëror (qendra e skijimit në Brezovicë), të banjave (burimet termale në Zveçan), malor (Leposaviq), kulturor, arsimor, sportiv, si dhe të gjuetarisë dhe peshkatarisë (Zubin Potok). Për momentin, kjo degë ekonomike, në veri, është gati jo ekzistente, ndërsa infrastruktura për turizëm është shumë modeste, derisa marrëdhëniet e pazgjidhura pronësore e vështirësojnë zhvillimin e infrastrukturës turistike<sup>20</sup>.

*Prodhimi i energjisë elektrike* nga thëngjilli (linjiti) është burimi kryesor i energjisë në Kosovë<sup>21</sup>. Prej prodhimit të përgjithshëm të energjisë elektrike, 90 % prodhohet nëpër reparte të Korporatës Elektro-energetike të Kosovës (KEK). Kosova importon 10 deri 15 % të nevojave të gjithmbarshme për rrymë. Kosova nuk ka burime të gazit dhe derisa nuk është e kyçur me linja të gazsjellësve, gazi përdoret vetëm nga “bombolat e gazit”. Kosova importon rreth gjysmë milioni ton të prodhimeve të naftës në vit. Prej burimeve alternative, në bregune Goleshit, në afërsi të aeroportit të Prishtinës po ndërtohet një park i erës. Duke marrë parasysh numrin e orëve me diell në vit, Kosova mund të mendojë edhe për energjinë solare. Kjo vlen gjithashtu edhe për idenë për gjenerimin e energjisë nga biomasa dhe nga burimet gjeo-terminale. Vetëm me lidhjen e sistemeve të elektro-energetikës të Kosovës dhe Shqipërinë me përçuesin prej 400 kV në vitin 2019, sistemet energetike të Serbisë dhe Kosovës fitojnë në rëndësi si potencial transmetues. Pasi të dy sistemet kanë nevojë për blerje të energjisë elektrike, është theksuar nevoja që sistemi transmetues Serbi – Kosovë të modernizohet dhe të forcohet deri në 400 kV.

19 Dr. Dušan Janjić, Sfidat e normalizimit. Analiza e negociatave dhe zbatimit të Marrëveshjes së Brukselit, Analiza, 1 A/ 2015, Forumi për marrëdhënie etnike, Beograd, 2015, 61, 62.

20 Njësoj, 62.

21 Rezervat e thëngjillit të murrmë (linjtit), vlerësimi i të cilit është midis 11 dhe 14 miliardë tonë, janë një nga më të pasurat në Evropë.



## Lidhshmëria e infrastrukturës

Në Kosovë *ambienti i infrastrukturës* është i pazhvilluar. Edhe pse Kosova nuk gjendet në trasenë e korridoreve pan evropianë, ajo është e lidhur me ato, edhe atë me korridorin VIII me autostradën “Ibrahim Rugova”, e cila e lidhë Prishtinën me Tiranën, dhe në zhvillim e sipër janë punimet në autostradën e cila lidhë Prishtinën me Shkupin (deri tani ka përfunduar pjesa e rrugës në Kosovë deri në kufi me Maqedoninë e Veriut) si dhe me korridorin X (Tiranë-Prishtinë-Nish).

Përkundër investimeve të konsiderueshme kapitale në infrastrukturën rrugore, rrjeti i rrugëve në Kosovë nuk është mjaftueshëm i zhvilluar, dhe kjo vështrëson lidhjen e shpejtë në vetë Kosovën por edhe me rajonin. Lidhja hekurudhore me Serbinë dhe Maqedoninë e Veriut ekziston, por jo edhe me Shqipërinë dhe Malin e Zi, megjithëse ekzistojnë kushtet teknike për vendosjen e trafikut. Mirëpo, nevojitet modernizimi i infrastrukturë hekurudhore<sup>22</sup>.

Në vitin 2011 Kosova ka filluar rindërtimin e kompanisë hekurudhore dhe e ka ndarë ndërmarrjen e cila merret me infrastrukturë (InfraKos) nga ndërmarrja e cila merret me operime (InfraTrain) ndërsa kohë më parë *Banka Evropiane për rindërtim dhe zhvillim* ka miratuar zgjerimin e huas për Qeverinë e Kosovës për rehabilitimin e drejtimit hekurudhor veri-jug, nga Leshaku deri në kufi me Maqedoninë Veriore (pjesa rreth linjës administrative është paraparë e fundit për ndërtim). Kosova ka dy aeroporte vendore (në Gjakovë dhe Podujevë) dhe një ndërkombëtar, në Prishtinë. Është paraparë edhe ripërtëritja e trafikut ajror midis Beogradit dhe Prishtinës<sup>23</sup>.

Kosova ka nëntë kalime kufitare dhe gjashtë kalime kufitare/administrative me Serbinë (Bërnjak, Jarinje, Mendare, Mutivodë, Dheu i Bardhë dhe Muçibabë). Në kuadër të dialogut teknik midis Kosovës dhe Serbisë gjatë viteve 2011 dhe 2012, janë nënshkruar marrëveshja e pastaj edhe protokollit teknik

22 Në margjinat e Konferencës për Siguri në Berlin, më 14 shkurt 2020, përfaqësuesit e qeverive të Kosovës dhe Serbisë, në praninë e Grenellit dhe presidentëve të Serbisë dhe Kosovës, kanë nënshkruar deklaratën për synimet e ripërtëritjes së trafikut hekurudhor në mes Beogradit dhe Prishtinës sipas rutës së përshkruar më herët.

23 Letrën mbi qëllimet, më 20 janar 2020, në ambasadën e Berlinit, e kanë nënshkruar në emër të Serbisë sekretari shtetëror i Ministrisë së Ekonomisë Milutin Trivunac ndërsa nga ana e Kosovës drejtori i përgjithshëm i Drejtorisë së Aviacionit Civil të Kosovës Eset Berisha, në praninë e Richard Grenell-it dhe këshilltarit të presidentit të SHBA për Siguri Kombëtare Robert O'Brien. Në relacionin Beograd-Prishtinë do të fluturojnë aeroplanët e transportuesit Lufthansa, Euro Wings. Njëkohësisht, kjo do të rrisë numrin e destinacioneve me të cilat është lidhur Kosova me trafik ajror. Njëkohësisht do të lehtësohet edhe transporti i postës. Gjithë kjo do të duhej të ketë efekt të konsiderueshëm pozitiv në forcimin e bashkëpunimit afarist midis Serbisë dhe Kosovës (Gazeta Express: Me marrëveshjen mbi linjën ajrore midis PR-BG shfuqizohen taksat; burimi: Gazeta Express/KoSev, 21 janar 2020, në dispozicion në: <https://kossev.info/gazeta-express-dokument-sporazumom-o-avio-liniji-izmedju-pristine-i-beograda-ukidaju-se-takse-srbiji/>)

mbi menaxhimin e përbashkët të kalimeve, por Serbia po vonohet në fazën e dytë të marrëveshjes, e cila nënkupton ndërtimin e objekteve të përhershme në kalimet, të cilat nuk kanë përfunduar as deri në fillim të vitit 2020.

Në raport me nevojën e gjithmbarshme për ujë në Kosovë, rezervat janë relativisht të vogla dhe teritorrialisht të renditura në mënyrë jo proporcionale, në dëm të pjesës lindore dhe juglindore. Sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm është pothuajse i pazhvilluar, duke pësuar humbje të konsiderueshme teknologjike dhe komerciale, dhe nuk mbërrin deri te pjesa e madhe e popullsisë. Nuk ka sistem të trajtimit të ujërave të zeza në Kosovë, ndërsa vetëm 40% e popullsisë dhe më pak se 10% e popullsisë rurale kanë qasje në sistemin e kanalizimit. Me lumin Ibër dhe liqenin artificial Ujmani, i cili pjesërisht është i vendosur në komunën e Zubin Potokut (dhe pjesërisht në komunat Tutin dhe Novi Pazar), veriu i Kosovës është i pasur me burime ujore. Sidoqoftë, furnizimi me ujë është i pamjaftueshëm, sepse bëhet përmes rrjetit të vjetër, dhe pëson humbje teknologjike. Trajtimi i ujërave të zeza është i papërshtatshëm, gjegjësisht uji i kanalizimit nga zonat urbane dhe rurale derdhet në Ibër ose në kanale të hapura, pa trajtim. Me këtë ndoten sipërfaqet e tokës dhe ujërat nëntokësorë dhe rritet rreziku nga përmytja dhe ndotja.

Për sa i përket mjedisit, problemet kryesore paraqesin ndotja e ajrit, mungesa dhe ndotja e ujit, degradimi i tokës dhe humbja e rolit të ekosistemeve. Rezultatet në fushën e klasifikimit, riciklimit dhe trajtimit të mbeturinave janë jashtëzakonisht të dobëta. Kërcënimi më i madh për mjedisin në Kosovë vjen nga kompleksi i xehetarisë dhe metalurgjisë “Trepça”, TC “Obiliq” dhe Fabrika e Betonit në Prishtinë.

Kosova mbetet prapa në zhvillimin e *infrastrukturës moderne telekomunikuese*. Shkalla e mbulimit të telefonisë fikse është ndër më të ulëtat në Evropë, ndërsa shkalla e parapagimit për shërbimet e telefonisë mobile është 74 %. Të licencuar janë dy operatorë të telefonisë fikse dhe internetit, Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës (PTK), e cila gjithashtu ofron shërbime postare. IPKO Telekommunications dhe Vala ofrojnë shërbime të telefonisë mobile. Për sa i përket mediave, Kosova ka 22 stacione televizive (3 kombëtare), 9 gazeta dhe 92 radio stacione.

## Konteksti shoqëror

Tregu i punës në Kosovë vuan nga papunësia e lartë dhe mundësitë e pamjaftueshme të punësimit, veçanërisht për të rinjtë që hyjnë në tregun e punës. Ekziston një mospërputhje e konsiderueshme midis aftësive të punëkërkuësve të rinj dhe kërkesave të tregut të punës, veçanërisht në nivelin profesional.

Papunësia e lartë në Kosovë shoqërohet me nivelin e lartë të *varfërisë*. Sipas analizës së buxhetit familjar të realizuar nga ASK, ajo tregon se 19% e qytetarëve janë të varfër. Bazuar në Sondazhin për Buxhetin e Ekonomive Familjare për vitin 2017 (SBEF), vlerësohet se 18% e popullsisë së Kosovës jeton nën kufirin e varfërisë dhe 5.1% jetojnë nën kufirin ekstrem të varfërisë<sup>24</sup>.

*Emigrimi* është një nga trendët kryesore demografike në Kosovë. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, numri i përgjithshëm i njerëzve të lindur në Kosovë që kanë emigruar nga Kosova është 380.826, që është 21.4 % e numrit të atyre që jetojnë në Kosovë. Destinacionet kryesore të emigrimit janë vendet e Evropës Perëndimore (Gjermani, Zvicër, Itali dhe Austri).

\* \* \*

Sistemet ekonomike të Serbisë dhe Kosovës janë zhvilluar si një nënsistem brenda sistemit të unifikuar ekonomik të ish-Jugosllavisë. Prandaj, me gjithë ndryshimet e rëndësishme, ekzistojnë shumë ngjashmëri dhe ndërvarësi të këtyre dy sistemeve ekonomike. Kjo lehtëson afarizmin dhe bashkëpunimin ekonomik bazuar në interesat ekonomike të partnerëve të barabartë.

Nga ana tjetër, të dy ekonomitë karakterizohen me produktivitet dhe konkurrencë të ulët, mospërputhje midis aftësive të fuqisë punëtore dhe kërkesave të tregut, me bazë modeste të eksportit, shkallë të lartë informaliteti, me infrastrukturë të pamjaftueshme të ndërtuar dhe të zhvilluar e cila në ndërthurje me presione socio-demografike shkakton cenueshmëri të jashtëzakonshme ekonomike dhe sociale dhe paqëndrueshmëri. Në të njëjtën kohë, secili nga këta faktorë, ndaras dhe kolektivisht, ndikon në shpejtësinë, drejtimin dhe cilësinë e procesit të normalizimit të marrëdhënieve, por edhe në forcën e sektorit privat për të kontribuar në tejkalimin e problemeve të së kaluarës dhe gjenerimin e përfitimeve të drejtpërdrejta për të dy komunitetet.

Në mënyrë që bashkëpunimi ekonomik dhe tregtia të zhvillohen dhe përmirësohen në një mënyrë të qëndrueshme, nevojiten përmirësime të konsiderueshme në shumë fusha, dhe para se gjithash në fushat e forcimit të konkurrencës dhe mjedisit të investimeve duke u harmonizuar me standardet e BE-së. Në atë mënyrë, krijohen politika të pajtueshme për biznes të përbashkët, projekte të përbashkëta, bashkim të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, e çka në shkëmbim ofron potencial për hapjen e hapësirave shtesë për bashkëpunim ekonomik dhe zgjidhje politike.

Realizimi i reformave të përgjithshme ekonomike dhe sociale të Kosovës dhe Serbisë dhe zhvillimi i dialogut në Bruksel dhe i procesit të normalizimit janë të ndërlihdura dhe të kushtëzuara reciprokisht. Përkatësisht, përparimi në

<sup>24</sup> Banka botërore, në dispozicion në: [https://databank.worldbank.org/views/reports/reportwidget.aspx?Report\\_Name=CountryProfile&Id=b450fd57&tbar=y&dd=y&inf=n&zm=n&country=XKX](https://databank.worldbank.org/views/reports/reportwidget.aspx?Report_Name=CountryProfile&Id=b450fd57&tbar=y&dd=y&inf=n&zm=n&country=XKX) (accessed on February 2020)

procesin e normalizimit ka efekte direkte dhe afatgjata pozitive në dinamizmin e bashkëpunimit afarist dhe intensifikimin e lidhjeve ekonomike dhe tregtare midis palëve. Së pari, implementimi i zgjidhjeve të dakorduara paraqet adoptimin e standardeve të reja evropiane në fushat me interes jetik për popullin e Kosovës dhe të Serbisë (për shembull, në avancimin e digjitalizimit të regjistrave publike, rritjen e lëvizjes së njerëzve, mallrave, shërbimeve dhe ideve, rritjen e kapaciteteve doganore dhe shërbimeve tjera, etj.)<sup>25</sup>. Në shkëmbim, bashkëpunimi i komunitetit të biznesit vepron si një faktor i rëndësishëm në procesin e normalizimit të marrëdhënieve, duke marrë parasysh se bashkëpunimi ekonomik dhe tregtia krijojnë përfitime të drejtpërdrejta ekonomike për të dy komunitetet dhe ka potencial të jetë një shtysë e rëndësishme për pajtimin në rajon.

Në këtë dritë, roli i udhëheqjes ekonomike, politike dhe të shtetit, është thelbësor dhe nga kapacitetet e tyre varen si shpejtësia dhe cilësia e zgjidhjeve ashtu edhe zbatimi i tyre. Kjo konfirmohet nga gjetjet e hulumtimeve empirike të kryera në kuadër të projektit me përfaqësues të biznesit nga të dy palët, të cilat tregojnë se ekziston një traditë e mirë e bashkëpunimit midis kompanive nga Kosova dhe Serbia, por që pengesa kryesore për intensifikimin e bashkëpunimit të tyre janë pikërisht marrëdhëniet politike dhe problemet e lidhura me ato.

Kjo konfirmohet qartë nga rezultatet e bashkëpunimit të tyre deri më tani, të cilat dëshmojnë se roli i politikës është jashtëzakonisht i rëndësishëm kur mbështet dhe madje edhe më i rëndësishëm kur bllokton, dekurajon bashkëpunimin e komuniteteve afariste. Një shembull pozitiv është vendimi për krijimin e Fondit të Përkohshëm për Zhvillim Ekonomik dhe Infrastrukturor të Veriut të Kosovës (Fondi), i cili u krijua në janar të vitit 2013 në bazë të një marrëveshje ndërmjet Kosovës dhe Serbisë për mbledhjen e të ardhurave doganore. Në bazë të kësaj marrëveshje, fondet e mbledhura nga doganimet në vendkalimet Jarinje dhe Brnjak ndahen për Fondin dhe shërbejnë për zhvillimin e komunave të Mitrovicës së Veriut, Leposaviqit, Zubin Potokut dhe Zveçanit. Qëllimi i formimit të Fondit është që të mundësohet një shkallë më e lartë e kualitetit të jetesës në këto komuna dhe të barazohet me nivelin e komunave tjera në Kosovë<sup>26</sup>. Nga themelimi i tij në vitin 2013 deri në dhjetor të vitit 2019, Fondi mbledhi mbi 15,729,416.72 euro, nga të cilat 11 milion u ndanë për zhvillimin e katër komunave në veri. Nga kjo shumë, 8.6 milion euro ose 78% janë shpenzuar për projekte kapitale<sup>27</sup>.

25 Dr. Dušan Janjić, Sfidat e normalizimit. Analiza e negociatave dhe zbatimi i Marrëveshjes së Brukselit, Analiza, 1 A/2015, Forumi për Marrëdhënie Etnike, Beograd, 2015, 55.

26 Tejkalimi i barrierave për afarizëm dhe normalizimi. Analiza e kornizës ligjvënëse ekonomike për afarizëm midis Serbisë dhe Kosovës, Forumi për Marrëdhënie Etnike, Heinrich Boll Stiftung Serbia, Mali i Zi, Kosova, Beograd, qershor 2017, 20.

27 Ministria e Financave e Kosovë (2020), komunikimi zyrtar me Muharrem Shahinin – Drejtorin e Sektorit për komunikime

Vendimi me veprim krejtësisht të kundërt është vendimi i Qeverisë së Kosovës për të futur një taksë prej 100 % për produktet nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina në nëntor 2018, dhe kështu shkëmbimi i mallrave me Kosovën praktikisht u pamundësua. Një masë e tillë padyshim që pati një ndikim domethënës jo vetëm në bashkëpunimin afarist dhe marrëdhëniet e besimit midis palëve, por edhe në marrëdhëniet dhe sjelljen e përgjithshme, duke minuar themelet dhe rezultatet e bashkëpunimit, gjegjësisht duke rrënuar përpjekjet e mëdha të angazhuara për të ndërtuar besimin dhe lidhjet midis bashkësive afariste. Taksat ishin në fuqi për shtatëmbëdhjetë muaj të plotë, derisa Qeveria e Kosovës më 31 mars 2020, mori një Vendim për pezullimin e kësaj mase në bazë të zbatimit gradual të parimit të reciprocitetit në marrëdhëniet me Serbinë<sup>28</sup>. Për dallim nga Serbia, taksat për import nga Bosnja dhe Hercegovina janë shfuqizuar pa kushte.

Efektet e drejtpërdrejta negative të kësaj mase janë tashmë të dukshme, gjë që ilustron më së miri nga vlerësimi i një rënie të madhe të eksporteve dhe plasmanit së produkteve në tregun e Kosovës, madje në vlerë prej 400 milionë euro në rastin e Serbisë<sup>29</sup>. Kompanitë e vogla dhe të mesme kishin humbje më të mëdha, ndërsa kompanitë shumëkombëshe që bënin biznes me Kosovën nga Serbia gjetën mënyra për të shitur mallra përmes vendeve të tjera të rajonit.

Nga ana tjetër, synimet e proklamuar për futjen e taksave ishin që prodhuesit vendas në Kosovë të përfitonin më shumë, se do të rriteshin prodhimi dhe punësimi. Sipas gjetjeve të hulumtimit të Institutit GAP nga Prishtina, i cili është realizuar gjatë muajit mars të vitit 2019, këto synime nuk janë arritur. Hulumtimi tregon se ka pasur një rritje të deficitit të tregtisë së jashtme të Kosovës për 5.4 % në krahasim me nëntor të vitit 2018, se nuk ka rritje të përshpejtuar të industrisë përpunuese të Kosovës, e matur si nga vëllimi i prodhimit ashtu edhe në drejtim të krijimit të vendeve të punës<sup>30</sup>. Kjo u pasua me një rritje drastike e importeve të mallrave në Kosovë nga Sllovenia, Kroacia, Hungaria, Maqedonia e Veriut, Greqia, Bullgaria dhe Turqia. Si pasojë e ndryshimit të vendit e origjinës së produkteve, niveli i përgjithshëm i çmimeve në tregun e Kosovës u rrit për 2.4 % në krahasim me shtator të vitit 2018, dhe sidomos me rritjen e çmimeve të ushqimit - veçanërisht çmimin e bukës dhe drithërave (12.5%), mishi (3.2%) dhe vajrat dhe yndyrat (3.0%)<sup>31</sup>.

28 Në vendim pretendohet: "1. Të gjitha marrëdhëniet tregtare me Serbinë, referencat të cilat janë përdorur në dokumentin e mëposhtëm do të jenë në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me legjislacionin në fuqi: 1. 1. Certifikatat fito sanitare dhe dokumentet përcjellëse për prodhimet ushqimore dhe jo ushqimore me prejardhje bimore dhe jo shtazore të cilat i nënshtrohen kontrollit fito sanitar në kufi. 1. 2. Certifikatat e veterinarisë dhe dokumentet përcjellëse për ushqim dhe prodhimet jo ushqimore me prejardhje shtazore i nënshtrohen kontrollit të veterinarisë në kufi.

29 Informacioni për vlerësimin e ndikimit të zbatimit të taksës në mallra nga Serbia qendrore me rastin e plasmanit në tregun UNMIK/ Kosovo, Beograd, nëntor 2019.

30 The impact of 100% tax on reduction and consumer prices in Kosovo Comparing periods: January - October 2018 and January - October 2019, Institut GAP, Prishtine, March 2020

31 *Burimi*: European Union (2019). Kosovo Economic Report March-April 2019, 11.

Përveç ndikimit të drejtpërdrejtë ekonomik që mund të përcaktohet në sasi, ndikimi i taksave në marrëdhëniet e besimit dhe mjedisit të afarizmit është i pamatshëm, për shkak të një ndryshimi të diskutit publik që dekurajon bashkëpunimin ekonomik, gjegjësisht e ngulfat aktivitetin e shëndoshë ekonomik dhe afarist dhe stimulon atë joformal.

Andaj, është e pakontestueshme që kjo masë të ketë implikime të gjera ekonomike dhe politike. Në të njëjtën kohë, kjo është një shkëlqje e drejtpërdrejtë e marrëveshjes së CEFTA-së, si një bazë për bashkëpunim dhe integrim në rajon. Thellimi i bashkëpunimit afarist dhe shkëmbimi tregtar midis Serbisë dhe Kosovës është i ngarkuar me një numër problemesh pikërisht për shkak të shkëlqeve të shpeshta të dispozitave të marrëveshjes së CEFTA-s dhe futjes së barrierave jo-doganore në tregtinë me produkte bujqësore dhe ushqimore, por edhe me disa produkte industriale. Barrierat jo-tarifore që rëndojnë marrëdhëniet ekonomike dhe rritin tensionet nga të dy palët janë kryesisht pengesat teknike në tregti, masat dhe standardet sanitare dhe fito sanitare, por edhe masat e kufizimit të eksportit ose masat anti damping, si dhe ato që lidhen me procedurat e prokurimit publik. Përveç barrierave që lidhen me statusin politik, gjegjësisht me statusin ndërkombëtar të Kosovës, ekziston një numër i konsiderueshëm i barrierave të tjera të natyrës dhe veprimeve të ndryshme, të cilat janë kryesisht pasqyrim i mos implementimit të asaj që është marrë vesh me marrëveshjet e Brukselit dhe CEFTA-s, dhe të cilat shpesh janë ekuivalente me ndalimet e importit. Megjithatë, numri më i madh i kufizimeve rezultojnë nga mosharmonizimi i ndërsjellët i rregullave dhe procedurave, gjegjësisht mosharmonizimi i tyre me normat dhe standardet e BE-së (mungesë e njohjes së ndërsjellët të vërtetimeve mbi kualitetin e prodhimeve, vërtetimeve mbi sigurinë e prodhimeve, rezultateve të testimeve laboratorike, dhe të ngjashme). Në këtë kontekst, duhen përpjekje të forta për të harmonizuar rregulloret dhe standardet si në fushën e sigurisë ushqimore dhe nivelet e cilësisë së prodhuesve, ashtu edhe për modernizimin e infrastrukturës së cilësisë (përfshirë standardizimin, vlerësimin e konformitetit, metodologjinë dhe akreditimin) me qëllim që të zvogëlohen ose eliminohen pengesat për tregti dhe të sigurohet qasje më e mirë për kompanitë si në tregjet e ndërsjella, ashtu edhe në ato rajonale dhe tregun e BE-së.

Andaj, derisa sfidat strukturore edhe më tutje mbeten të mëdha, zbatimi i asaj që tashmë është marrë vesh në kuadër të Marrëveshjes së Brukselit dhe lidhja e ekonomive të Serbisë dhe Kosovës përmes nismave dhe marrëveshjeve rajonale imponon një imperativ që forcat e tyre të bashkohen dhe të jenë një inkurajim i fortë për normalizimin e marrëdhënieve midis Beogradi dhe Prishtinës.

# IV Ndërvarësia e procesit të hyrjes në be dhe normalizimit të marrëdhënieve të Serbisë dhe Kosovës

Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të KB përcaktoi dialogun midis Serbisë dhe Kosovës nën patronazhin e BE-së (Dialogu i Brukselit) në mënyrë si vijon: “Normalizimi është në funksion të vendosjes së paqes, sigurisë dhe stabilitetit në Ballkanin Perëndimor, promovim të bashkëpunimit dhe të kushteve ku njerëzit jetojnë”<sup>32</sup>. Deri më tani, janë arritur 48 marrëveshje brenda dialogut, një numër i konsiderueshëm i “konkluzioneve të dakorduara”, planeve të veprimit dhe protokolleve teknike. Hapi vendimtar u mor me 19 prill 2013, kur u bë parafimi i *Marrëveshjes mbi Parimet*, dhe më 22 maj, kur u pajtua për planin për implementimin e saj. Rëndësia e kësaj marrëveshje është edhe në atë se kjo paraqet shenjëne parë që palët janë pajtuar të shikojnë përpara për të zvogëluar armiqësitë. Dhe derisa ekziston një shkallë relativisht e lartë e pajtimit për natyrën e Marrëveshjes mbi Parimet, është i theksuar një mospajtim për përmbushjen e disa pjesëve të marrëveshjes, sidomos të atyre që kanë lidhe me Bashkësinë / Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe (AKS)<sup>33</sup>.

32 UN SC Resolution 64/298 [http://www.un.org/en/ga/search/view\\_doc.asp?symbol=A/RES/64/298](http://www.un.org/en/ga/search/view_doc.asp?symbol=A/RES/64/298)

33 Dušan Janjić, “Sfidat e normalizimit: Analiza e procesit negociator dhe e zbatimit të marrëveshjes së Brukselit”, Analiza, Forumi për Marrëdhënie Etnike, Beograd 2015.

Për afrimin e komuniteteve afariste, me rëndësi të veçantë janë Marrëveshja për Lirinë e Lëvizjes<sup>34</sup>, e cila është mbështetur me Marrëveshjen për Menaxhimin e Integruar të Kufijve<sup>35</sup>, evidentimin dhe mbledhjen e taksave doganore dhe TVSH-së, për vulën doganore, është themeluar Fondi i Përkohshëm për Zhvillimin Ekonomik dhe Infrastrukturor të Veriut të Kosovës (Fondi), për energjetikën<sup>36</sup>, dhe për telekomunikime<sup>37</sup>. Zbatimi i këtyre marrëveshjeve mundëson vendosjen e standardeve evropiane të cilat e përkrahin procesin e normalizimit të marrëdhënies midis Kosovës dhe Serbisë dhe krijimit të supozimit për heqjen e pengesave për zhvillim më të shpejtë ekonomik të Kosovës, përfshirë edhe veriun e Kosovës.

Procesi i adoptimit të *fryteve juridike (acquis-in)* mund të çojë në marrëdhënie më të harmonizuara ekonomike dypalëshe midis Serbisë dhe Kosovës, paqë do të zhvillohet në baza juridike *identike dhe të harmonizuara*. Serbia nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit në nëntor të vitit 2007. Kosova nënshkroi Marrëveshjen përkatëse të Stabilizim-Asociimit në tetor të vitit 2015 (ndryshe nga MSA e BE-së me vendet e Ballkanit Perëndimor, të cilat janë të një karakteri “të përzier” – dmth të nënshkruar njëkohësisht nga ana e BE si e tillë, dhe nga vendet anëtare të saj, MSA e BE-së me Kosovën u lidh vetëm në emër të BE-së, e jo nga shtetet anëtare të saj). Këto marrëveshje kanë dispozita të ngjashme, gjegjësisht të krahasueshme për bashkëpunimin rajonal, si dhe për detyrimin për të marrë përsipër *acquis-in* e BE-së<sup>38</sup>.

- 34 Liria e lëvizjes është vendosur me “konkluzionet e dakorduara” më 02 korrik 2011, ndërsa më 02 dhjetor të vitit të njëjtë janë harmonizuar Konkluzionet Operative, të cilat kanë të bëjnë me zbatimin e kësaj marrëveshjeje. Zbatimi i kësaj marrëveshjeje ka filluar më 26 dhjetor 2011. Marrëveshja rregullon shfrytëzimin e letërnjoftimeve kosovare, patentëve të shoferit, regjistrimin e automjeteve dhe sigurimet por janë vendosur edhe procedurat e reja të udhëtimit midis Kosovës dhe Serbisë. Udhëtarët e parë me letërnjoftimet kosovare kanë filluar të udhëtojnë nëpër Serbi më 01 maj 2013. (Tejkalimi i barrierave për afarizëm dhe normalizim. Analiza e kornizës ligjore ekonomike për afarizëm midis Serbisë dhe Kosovës, Forumi për Marrëdhënie Etinke, Heinrich Boll Stiftung, Serbia, Mali i Zi, Kosova, Beograd, qershor 2017, 13).
- 35 Kontrolli i Integruar i Kufijve (IBM), i dakorduar në periudhën prej 30 nëntorit 2011, ndërsa zbatimi ka filluar më 10 dhjetor 2012. (Tejkalimi i barrierave për afarizëm dhe normalizim. Analiza e kornizës ligjore ekonomike për afarizëm midis Serbisë dhe Kosovës, Forumi për Marrëdhënie Etinke, Heinrich Boll Stiftung, Serbia, Mali i Zi, Kosova, Beograd, qershor 2017, 14, 15).
- 36 Marrëveshjet në fushën e energjetikës me të cilat rregullohen marrëdhëniet midis RRES dhe KOSTT-ti, të parafuara më 08 shtator 2013 në bazë të cilit KOSTT u bë anëtar i ENTSO, dhe kështu në qershor 2020 u bë zonë epavarur e kontrollit. Në bazë të kësaj marrëveshjeje “Elektrokosmeti” u transformua në një ndër-marrje të re “ElektroSever”, e cila deri në tetor 2020 duhet ta marrë licencën si furnitor dhe distribues i rrymës për katër komuna në Veritë Kosovës, ndërsa KOSTT është përgjegjës për transmetim të energjisë elektrike deri të rrjetet kryesore elektrike nga jashtë dhe nëpër Kosovë (Shih: <http://www.balkaninsight.com>).
- 37 Gjatë vitit 2013 është arritur marrëveshja sipas të cilës Kosova e fiton prefiksin e saj – numrin 383. Gjithashtu është mundësuar që Telekom Srbija sh. a. të regjistrojë në Kosovë një njësi afariste e cila do t’i kryej punët e telefonisë mobile dhe të internetit në mjedis të banuara me shumicë të pjesëtarëve të komunitetit serb. Gjithashtu u arrit edhe Marrëveshja Teknike mbi harmonizimin e shfrytëzimit të spektrit për sinjalin GSM dhe televizion. Zbatimi i plotë i kësaj marrëveshjeje u realizua vetëm gjatë vitit 2019.
- 38 Disa nga obligimet nga neni 13 i MSA ndërmjet BE-së dhe Kosovës duhet të ndikojnë në mënyrë të tërthortë në bashkëpunimin bilateral ekonomik midis Kosovës dhe Serbisë. Me këtë nen, Kosova duhet të lehtësojnë indirekt bashkëpunimin ekonomik dypalësh me Serbinë, Kosova ndërmerr gradualisht



Me qëllim të integritimit në BE, Serbia miraton një NPAA të rregullt. Rishikimi i fundit, i tretë i NPAA u miratua në mars të vitit 2018<sup>39</sup>. Sipas NPAA, është planifikuar që legjislacioni të harmonizohet plotësisht me të drejtën e BE-së deri në fund të vitit 2021, dhe më pas pason një periudhë e monitorimit të zbatimit të rregulloreve deri në anëtarësim. Në mars të vitit 2016, Kosova miratoi NPISAA, i cili parashikon reforma legjislative afatmesme në periudhën 2016-2020, me qëllim të zbatimit të MSA-së dhe harmonizimit të legjislacionit kombëtar<sup>40</sup>.

Kur bëhet fjalë për shkallën e harmonizimit të rregulloreve në çështjet rregullative të BE-së në *fushën e lëvizjes së lirë të mallrave, shërbimeve dhe kapitalit*, dokumenti më i rëndësishëm krahasues në këtë fushë është Raporti Komisionit Evropian për Politikë të Zgjerimit, i botuar në parim çdo vit (raporti i fundit është nga maji i vitit 2019)<sup>41</sup>. Komisioni Evropian tregon në atë dokument se Serbia në tërësi është “e përgatitur në mënyrë të moderuar” kur bëhet fjalë për funksionimin e ekonomisë së tregut dhe përfshirjen në konkurrencën e tregut. Nga ana tjetër, Kosova është në një “fazë të hershme” të përgatitjeve për përfshirje në ekonominë e tregut, me ekzistencën e një ekonomie gri dhe korrupsionshumë të përhapur.

Në vlerësimet veç e veç për disa kapituj të caktuar, Komisioni Evropian vlerëson se Serbia është “e përgatitur në mënyrë të moderuar” për të tre kapitujt që lidhen me lëvizjen e mallrave, shërbimeve dhe kapitalit (kapitujt 1, 3, dhe 4), ndërsa “niveli i mirë i përgatitjes” është arritur në fushën e unionit doganor (Kapitulli 29). Në rastin e Kosovës, në fushën e lëvizjes së mallrave (Kapitulli 1) dhe kapitalit (Kapitulli 4) është arritur një “nivel i mirë i përgatitjes”, ndërsa në rastet e Kapitullit 3 (shërbimet) dhe Kapitullit 29 (unioni doganor) vlerësimi është diçka më i mirë - “e përgatitur në mënyrë të moderuar”. Në krahasim me raportin paraprak nga viti 2018, Serbia në asnjërin prej 4 kapitujve të përmendur nuk ka marrë vlerësim më pozitiv sesa në vitet e kaluara, derisa Kosova ka përparuar kur bëhet fjalë për Kapitullin 1 (lëvizja e mallrave) nga “fazë e hershme” në “nivel të caktuar të përgatitjes”.

Për lëvizjen e lirë dhe të papenguar të mallrave në treg, me rëndësi të madhe është ekzistimi i një marrëveshje të re dhe të përshtatshme, e ashtuquajtura “infrastruktura e kualitetit” nga e cila varet kontrolli i zbatimit të rregullave teknike dhe standardeve mbi prodhimet, dhe kështu mundësia eventuale e “njohtjes së ndërsjellë” të institucioneve, si dhe të dokumenteve të tyre të lëshuara për cilësinë ose respektimin e standardeve, si një parakusht për shkëmbim të

normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, për të zbatuar të gjitha marrëveshjet e rena dakord dhe për të respektuar parimet e bashkëpunimit rajonal. (Stabilisation and association agreement between the European Union and the European Atomic Energy Community, of the one part, and Kosovo \*, of the other part, OJEU, L 71).

39 <http://www.mei.gov.rs/srl/dokumenta/nacionalna-dokumenta/hpaa>

40 <http://mei-ks.net/en/national-programme-for-implementation-of-saa>

41 European Commission, 2019 Communication on EU Enlargement Policy, COM (2019) 260 final, Brussels

lirë. Në përgjithësi mund të thuhet se *Serbia është në një nivel më të lartë të miratimit të rregulloreve ekuivalente me rregullat e Bashkimit Evropian*, si dhe në formimin e institucioneve të cilësisë, nga të cilat varet mundësia e anëtarësimit në organet ndërkombëtare për standardizim dhe rregulla teknike. Në këtë kontekst, është posaçërisht e rëndësishme që Serbia dhe Kosova të harmonizojnë sa më shumë legjislacionin e tyre me rregulloret e Bashkimit Evropian të cilat rrjedhin nga nenet 34-36 të Traktatit për Funksonimin e BE-së<sup>42</sup>. Kështu që Serbia është anëtare me të drejta të plota e organeve evropiane përgjegjëse për standardizimin (CEN, CENELEC). Ka miratuar standardet evropiane të përcaktuara nga CEN në një vëllim prej 98.11%; si dhe standardet CENELEC në vëllim prej 76.18%. Serbia gjithashtu ka 590 organe përgjegjëse për përcaktimin e konfirmimit të prodhimeve në krahasim me 39 organe të tilla në Kosovë. Organet kosovare përgjegjëse për akreditim si dhe për standarde, ende nuk janë përfshirë në strukturat përkatëse evropiane, ndryshe nga organet nga Serbia.

\* \* \*

Zbatimi i Marrëveshjeve të Brukselit deri më tani ka dhënë efekte të kufizuara në përmirësimin e bashkëpunimit të ndërsjellë midis Serbisë dhe Kosovës, mirëpo është e rëndësishme të theksohet se marrëveshjet e arritura, së bashku me të gjitha sfidat e zbatimit, u kanë mundur afaristëve të të dy palëve të veprojnë në një kornizë afariste më të rregullt dhe më të parashikueshme. Mirëpo, një nga faktorët e rëndësishëm që pengon afarizmin e ndërsjellë është mjedisi ekzistues makroekonomik - prej kufizimeve në procesin e ndërtimit të sistemit ekonomik të Kosovës deri në mjedisin e afarizmit në Serbi, i cili është nën ndikim të çështjes së pazgjidhur politikisht të statusit të Kosovës. Historia mëson se procesi i ndërtimit të dy sistemeve të pavarura nga sistemi ekonomik dikur i unifikuar nuk është as i shpejtë dhe as i lehtë. Aktualisht, shpresat e reja të Kosovës dhe Serbisë për normalizimin e marrëdhënieve po drejtohen kah bashkëpunimit rajonal-i Ballkanit Perëndimor, mirëpo duhet të merret parasysh se mjedisi politik i sigurisë në Ballkanin Perëndimor ende nuk është plotësisht i konsoliduar gjë që mund të paraqesë sfidë. Sipas të gjitha gjasave, mbetet që kapacitetet ekonomike dhe kapacitetet e tjera të organizohen “nga poshtë”, nga Kosova dhe Serbia, dhe që me instrumentet rajonale dhe evropiane vetëm të mbështeten reformat e vendeve të caktuara<sup>43</sup>.

42 Me nenin 34 ndalohen kufizimet kuantitative dhe masat me efekt ekuivalente në shkëmbimin në mes vendeve anëtare. Në nenin 36 parashihen përjashtimet nga dispozitat e nenit 34 të cilat kanë të bëjnë me rrethanat në lidhje me sigurinë publike, moralin publik, mbrojtjen e jetëve të njerëzve, kafshëve dhe bimëve, mbrojtjen e veprave të artit dhe e pronës intelektuale.

43 Tejkalmi i barrierave për afarizëm dhe normalizim. Analiza e kornizës ekonomike dhe ligjvënëse për afarizëm në mes të Serbisë dhe Kosovës, Formi për Marrëdhënie Etnike, Heinrich Boll Stiftung, Serbia, Mali i Zi, Kosova, Beograd, qershor 2017, 22.

Procesi i normalizimit lehtëson vendimmarrjen politike për bashkëpunimin ekonomik (sidomos në fushat e rrjedhës së mallrave, telekomunikacionit, ndërtimit të infrastrukturës dhe në sigurinë energjetike) të Serbisë dhe Kosovës, e me këtë lehtëson dhe mbështet forcimin e këtij bashkëpunimi. Nga ana e saj, siguria energjetike dhe bashkëpunimi ekonomik midis Serbisë dhe Kosovës është një nga shtyllat e normalizimit të përgjithshëm midis Kosovës dhe Serbisë, si dhe marrëdhëniet e tyre të ndërsjella<sup>44</sup>.

Procesi i normalizimit është në funksion të vendosjes së paqes, sigurisë dhe stabilitetit në Ballkanin Perëndimor, të promovimit të bashkëpunimit, përparësive për anëtarësim në BE, për përmirësimin e kushteve në të cilat njerëzit jetojnë ashtu që gjatë procesit të adoptojnë disa fryte juridike evropiane apo “standarde”. Procesi i normalizimit, nga ana tjetër, lehtëson vendimet politike dhe afariste për bashkëpunimin, dhe ky bashkëpunim është një nga elementët e rëndësishme të zhvillimit ekonomik dhe normalizimit të përgjithshëm midis Kosovës dhe Serbisë.

44 Sektori energjetik i Serbisë dhe Kosovës: Analiza preliminare, „Forumi për Marrëdhënie Etnike”, 2017, Beograd/ Prishtina, qershor, 2017, 5.



## V Konteksti rajonal dhe dinamika

Pakti i Stabilitetit për Evropën Jug-Lindore u krijua në 1999. Që nga atëherë, një numër iniciativash në formate të ndryshme janë nisur për të inkurajuar bashkëpunimin dhe afrimin midis vendeve të Ballkanit Perëndimor. Territori i caktuar si Ballkani Perëndimor përfshin Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Kosovën, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi dhe Serbinë. Përkundër një vendndodhje të mirë, klimës dhe burimeve të konsiderueshme natyrore, gjeografikisht dhe ekonomikisht këto janë ekonomi relativisht të vogla dhe të lidhura në mënyrë të pamjaftueshme me potenciale modeste të tregut dhe zhvillimit, dukshëm mbeten prapa Evropës së zhvilluar. Për sa i përket vëllimit dhe kapacitetit të tregut, Ballkani Perëndimor në tërësi mund të konkurrojë me vendet e zhvilluara, të sigurojë një zhvillim të qëndrueshëm afatgjatë dhe të tërheqë investitorë të huaj. Sidoqoftë, trashëgimia e së kaluarës, marrëdhëniet e ndërlikuara politike dhe ekonomike po prodhojnë një nivel relativisht të ulët të bashkëpunimit dhe lidhjes ekonomike të ndërsjellë. Me pak fjalë, performanca e dobët ekonomike e kombinuar me paqëndrueshmërinë politike vazhdon të pengojë rajonin të bëhet një treg tërheqës për investime dhe zhvillime të reja.

Rrethanat ndërlikohen më tej nga fakti që Ballkani Perëndimor është në një fazë të përparuar të depopullimit. Rreth 18 milion njerëz jetojnë në një zonë të populluar rrallë prej 207.763 km katrore. Sipas Eurostat, në periudhën 2008-2019, popullsia ka rënë me rreth 1.2 milion qytetarë, për shkak të nivelit të ulët të natalitetit dhe depopullimit në shumicën e rajoneve, të shkaktuara nga migrimet masive jashtë vendit (migracioni ekonomik), veçanërisht i të rinjve. Duke pasur parasysh trendin aktual, popullsia e rajonit do të vazhdojë të bjerë, gjë që do të kufizojë gjithashtu fuqinë punëtore - një nga faktorët kryesorë të zhvillimit ekonomik. Sipas statistikave kombëtare, numri i vlerësuar i banorëve

në rajon është 18 milion, por në fakt ka ndoshta dy deri në tre milion njerëz më pak, duke pasur parasysh një numër të konsiderueshëm të qytetarëve që “përkohësisht” janë duke punuar jashtë për një periudhë të gjatë kohore, por ende llogariten në statistika. Sipas Bankës Botërore, migrimi ekonomik është (përqindja sipas popullsisë) më e theksuar në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Mal të Zi, e ndjekur nga Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Kosova dhe Serbia. Masat e qeverive lokale drejt rritjes së natalitetit kanë prodhuar rezultate shumë të kufizuara, kështu që mund të priten vetëm ndryshime mekanike demografike. Kjo ka formuar një diasporë të madhe që transferon para në rajon përmes dërgesave të parave në familjet e tyre, e cila është veçanërisht e rëndësishme për aktivitetin e konsumatorit në pjesë më pak të zhvilluara të vendit.

Sipas të dhënave të Bankës Botërore, aktiviteti i përgjithshëm ekonomik i Ballkanit Perëndimor i matur me shumën e *BPV-ve* individuale është rreth 113 miliardë dollarë amerikanë me një normë rritjeje prej 3.2 % në 2019. *BPV-ja* rajonale kryesisht bazohet në komponentin e konsumatorit (rreth 60%), i cili mbështetet nga shpenzimet publike dhe me një fluks të fortë të dërgesave nga bota e jashtme (veçanërisht në Bosnje dhe Hercegovinë). Megjithatë rritja e normës së shtimit të *BPV-së* në vitet e fundit mund të interpretohet si zhvillim ekonomik të këtyre vendeve, kjo është vetëm pjesërisht e vërtetë. Rritjet e arritura të rritjes me një pjesë të madhe janë për shkak të rënies së madhe të prodhimit në dekadën paraprake, pra pozitës së ulët fillestare, për këtë arsye hendeku me vendet e zhvilluara mbetet i pandryshuar. Për këtë më së miri dëshmon fakti se *BPV* mesatare për kokë banori në rajon në vitin 2019 ishte 6,412 dollarë, e që është vetëm 18 % e mesatares së BE-së.

Pavarësisht nga rënia drastike e shkallës së *papunësisë*, në periudhën 2014-2019, nga rreth 24 % në 15 %. Ballkani Perëndimor ka një problem të theksuar të *papunësisë*. Shkalla e lartë e *papunësisë* së bashku me shkallën e lartë të punësimit jo formal pasqyrojnë më së miri gjendjen e këtyre ekonomive dhe proceseve shoqërore të cilat zhvillohen në to.

Në periudhën 2014-2019 norma e *inflacionit* ishte relativisht e ulët dhe e parashikueshme, duke filluar nga 1-2.2%. Ekonomitë e Ballkanit Perëndimor aktualisht gëzojnë një shkallë të konsiderueshme të stabilitetit të çmimeve, gjë që është kryesisht për shkak të rënies globale të çmimeve të mallrave, si dhe të regjimeve të qëndrueshme të kurseve devizore. Gjatë vitit 2019, bilanci fiskal i rajonit u rrit paksa në -2% të *BPV-së* (deficiti buxhetor), por *borxhi publik* mbeti nën 50% të *BPV-së*, domethënë dukshëm nën “kriteret e Maastricht-it” (rritje drastike e borxhit publik në raport me *BPV-në* u regjistrua vetëm në Malin e Zi, nga 60 % në vitin 2014 në 78.6 % në vitin 2019).

*Investimet direkte të huaja* në gjithë rajonin kanë ngecur në periudhën 2013-2015, me një shumë mesatare vjetore prej rreth 4.7 miliardë dollarë<sup>45</sup>.

Një rritje e shpejtë e IHD-ve erdhi në fillim të vitit 2016 dhe në 2018 hyrja neto e investimeve arriti në 7.4 miliardë dollarë. Sidoqoftë, niveli ose sasia e investimeve nuk është me rëndësi vendimtare për zhvillimin e rajonit, por mbi të gjitha cilësia e tyre. Disa prej investimeve vetëm e zgjerojnë tregun për investitorët, por nuk kontribuojnë në mënyrë thelbësore në prodhim dhe në zhvillimin teknologjik, i cili madje në një periudhë afatgjatë mund të çojnë në dalje të kapitalit dhe rritje të papunësisë. Gjatë viteve të fundit, si aktivitetet e investimeve të brendshme ashtu edhe ato të huaja kishin një pjesëmarrje më të lartë në strukturën e BPV-së, por përbërësi negativ në formën e deficitit të tregtisë së jashtme ka ulur rritjen e BPV-së.

*Bilanci i tregtisë së jashtme* të rajonit është jashtëzakonisht negativ, me çka vitet e fundit është rritur deficieti i llogarisë rrjedhëse të bilancit në 6.3 % të BPV-së në vitin 2019, me një tendencë rënie në kontekstin e krizës aktuale. Vëllimi dhe struktura aktuale e tregtisë së jashtme rajonale pasqyrojnë nivelin e zhvillimit dhe strukturës së këtyre ekonomive, si dhe politikën të cilën e ndjekin individualisht vendet në bashkëpunimin e ndërsjellë ekonomik. Shikuar në përgjithësi, në strukturë mbizotërojnë prodhimet bujqësore, lëndët e para, prodhimetgjysmë të gatshme, gjegjësisht prodhimet me një nivel të ulët të përpunimit teknologjik, ndërsa në importe mbizotërojnë produktet finale. Një strukturë e tillë e tregtisë së jashtme është tregues i konkurrencës së ulët të këtyre ekonomive, kështu që edhe vëllimi i saj është dukshëm nën nevojat dhe mundësitë reale. Plotësimi i ulët i këtyre ekonomive është një arsye për vëllimin e ulët të tregtisë dhe integrimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor, pasi struktura e tyre ekonomike është relativisht e ngjashme, e shënuar me zhvillim të ulët teknologjik. Me fjalë të tjera, këto ekonomi karakterizohen nga produktiviteti i ulët, baza e hollë ekonomike dhe eksporti, investime të drejtpërdrejta të huaja të kufizuara në teknologji të larta, nivel i lartë i informalitetit, i cili shoqëruar me paqëndrueshmëri politike dhe presione socio-ekonomike kufizon mundësitë e shkëmbimit ekonomik dhe tregtar.

Zhvillimi i bashkëpunimit në Ballkanin Perëndimor pasqyrohet në rrethana sfiduese politike dhe socio-ekonomike, pasi të gjitha përpjekjet bëhen në prapavijë të kufizimeve të rëndësishme, dy prej të cilave janë mbizotëruese: marrëdhëniet komplekse bilaterale midis Serbisë dhe Kosovës dhe zbatimi jo adekuat i politikës rajonale. Për këtë më së miri dëshmojnë parametrat e prezantuar makroekonomike, të cilat tregojnë se niveli i zhvillimit ekonomik dhe i lidhjes midis vendeve të Ballkanit Perëndimor është ende shumë nën nivelin e kërkuar dhe të dëshirueshëm. Përparimi në këtë fushë kërkon reforma të përsheptuara strukturore dhe një kornizë koherente rajonale me anë të së cilës vendet do të miratonin të njëjtat rregulla dhe standarde, të harmonizuara me rregulloret e BE-së. Nën një kornizë të tillë, zbatimi i marrëveshjeve bilaterale ekzistuese dhe të ardhshme midis Serbisë dhe Kosovës do të ishte më efikas sepse sigurohet gjithashtu nga detyrimet dhe vendimet e duhura rajonale, dhe

do të çonte në normalizimin e marrëdhënieve midis të dy palëve dhe të gjithë rajonit. Sidoqoftë, kërkesat dhe sfidat me të cilat përballen ekonomitë e Ballkanit Perëndimor sugjerojnë që iniciativat rajonale kanë bërë progres të kufizuar në këtë drejtim. Për të përmirësuar dhe forcuar lidhjen ekonomike dhe të biznesit midis këtyre ekonomive, kryesisht Serbisë dhe Kosovës, është thelbësore të kuptohen pengesat, si politike ashtu edhe ato të futura për të mbrojtur tregun e brendshëm, të cilat po pengojnë rrugën.



## VI Bashkëpunimi rajonal

Bashkëpunimi rajonal në Ballkanin Perëndimor është një parakusht i domosdoshëm për arritjen e stabilitetit politik dhe marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, si një qëllim themelor i politikës së integrimit evropian, sidomos duke pasur parasysh faktin se të gjitha vendet përveç Shqipërisë kanë ardhur nga një shtet i përbashkët në të cilin ata kanë adoptuar zakonet e ngjashme të afarizmit dhe kanë fituar ndërvarësi ekonomike. Secila prej nismave ekzistuese rajonale ka kontribuar në ripërtëritjen e frymës së bashkëpunimit dhe partneritetit rajonal, duke mbështetur procesin e ndërtimit të besimit dhe kohezionit social në rajon. Në këtë dritë, është e vështirë të mbivlerësohet rëndësia dhe roli i tyre. Sidoqoftë, përkundër krijimit të një numri të konsiderueshëm aranzhimesh për integrimin rajonal, ekonomitë e Ballkanit Perëndimor në një masë të madhe mbeten të pa integruar. Përpjekjet për të ndërtuar një rajon të konsoliduar janë minuar nga kompleksiteti i marrëdhënieve bilaterale, gjë që përforcon copëzimin dhe cenueshmërinë e të gjithë rajonit.

Lidhshmëria rajonale është temë qendrore në iniciativa të ndryshme, dhe më të rëndësishmet prej tyre janë paraqitur shkurtimisht në vazhdim.

*CEFTA 2006* është një marrëveshje tregtare dhe përfaqëson gur themelin e bashkëpunimit rajonal në fushën e marrëdhënieve ekonomike dhe tregtare. Qëllimi kryesor i krijimit të *CEFTA 2006* është lidhja ekonomike e vendeve nënshkruese, me heqjen e pengesave tregtare dhe lehtësimin e kushteve për zhvillimin e mëtejshëm të tregtisë. Palët e *CEFTA-së* kanë bërë përparim të konsiderueshëm në krijimin e një zone të tregtisë së lirë, heqjen e kuotave dhe kufizimeve doganore dhe obligimin për liberalizimin gradual të tregtisë me shërbime në përputhje me rregullat, standardet dhe praktikatat e BE-së në fushat e konkurrencës, prokurimit publik dhe të drejtave të pronësisë intelektuale.

Korniza të cilën e ofron *CEFTA 2006*, e nënshkrues të cilës janë edhe Serbia edhe UNMIK-u në emër të Kosovës (UNMIK-Kosovë), ka kontribuar në rritjen e tregtisë së tyre dypalëshe, heqjen e disa pengesave të caktuara

jo-doganore, dhe të kuptojnë më mirë rëndësinë e lidhjeve tregtare duke marrë parasysh se CEFTA është një destinacion i rëndësishëm eksporti për të dy ekonomitë. Rëndësia e tregut të CEFTA-s për të dy ekonomitë paraqitet nga të dhënat për vlerën e eksporteve dhe pjesën e CEFTA-s në eksportet e tyre totale<sup>46</sup>. Përkatësisht, vlera e realizuar e eksporteve të Serbisë ishte 3.2 miliardë euro, ose 19 % e eksporteve të saj të përgjithshme në vitin 2018; në Kosovës janë eksportuar 412 milion, ose 13% e eksporteve të përgjithshme në tregun e CEFTA. Destinacioni kryesor për eksportet serbe në kontekstin e tregut rajonal është BeH me 40% të eksporteve të përgjithshme të CEFTA-së, dhe Mali i Zi me 24%. Është edhe më e rëndësishme të theksohet se Serbia realizon një tepëri të konsiderueshme në këmbim me ekonomitë e CEFTA-së, e cila në vitin 2018 arriti në 2.2 miliardë euro. Nga ana tjetër, eksportet e Kosovës në tregun e CEFTA-s në vitin 2018 arritën në 173.5 milion euro, ose 47 % të eksporteve totale. Nga kjo, 33.5 milion u eksportuan në tregun serb ose 19 % të eksporteve të përgjithshme të CEFTA-s, gjegjësisht 48.2 milion dhe 26 % në vitin 2017. Tregu më i rëndësishëm rajonal për eksportin e Kosovës është tregu i Shqipërisë me 39 % të eksportit të përgjithshëm të CEFTA-s, gjegjësisht Maqedonia e Veriut me 25 %.

Mirëpo, fakti që UNMIK-u është nënshkruar i marrëveshjes në emër të Kosovës paraqet një barrë të konsiderueshme për marrëdhëniet dhe funksionimin e CEFTA-së, dhe Kosova në shumë raste ka theksuar se do të tërhiqet nga CEFTA nëse marrëveshja nuk ndryshohet dhe Kosova nuk përfaqësohet në mënyrë të barabartë (si Republika e Kosovës), njëkohësisht duke sugjeruar mundësinë e pranimit të një mënyre alternative të përfaqësimit përveçse nën emrin kushtetues. Ndryshimi i emrit nënkupton pëlqimin e të gjitha palëve, përfshirë Serbinë, gjë që nuk ka ndodhur deri më tani. Për shkak të sfidave të shumta me të cilat përballlet ekonomia e Kosovës në kontekstin e tregtisë me rajonin me një deficit kronik tregtar, CEFTA gjerësisht perceptohet si e pafavorshme për zhvillimin e ekonomisë së Kosovës, pra që prodhimi vendor nuk ishte gati për liberalizimin e papritur të tregtisë së jashtme të cilin e ka sjellë CEFTA në vitin 2006.

Në këtë dritë, lidhjet dypalëshe tregtare mbesin të ngarkuara nga një numër pengesash, që përveç atyre që lidhen me statusin politik dhe ndërkombëtar të Kosovës, mbizotërojnë pengesat administrative dhe teknike - certifikatat tregtare të pa harmonizuara për qarkullim të mallrave, moszbatimi ose interpretimi i pabarabartë i Marrëveshjeve të Brukselit – dhe si më e rëndësishmja, mungesë e vullnetit politik për normalizimin e marrëdhënieve, i cili pasqyrohet në pakënaqësinë dhe ankesat e vazhdueshme të sektorit privat.

46 Burimet e të dhënave janë statistikat zyrtare: Enti Republikan për Statistika të Serbisë (<https://www.stat.gov.rs/>) dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës (<https://ask.rks-gov.net/en/kosovo-agency-of-statistics>) si dhe statistika e CEFTA-s (<https://statistics.cefta.int/home>).

Si përgjigje për nevojën për të hequr pengesat e mbetura jo-tarifore në tregtinë kornizën e CEFTA-s është integruar Protokollin shtesë 5 si një marrëveshje për lehtësimin e tregtisë, i cili hyri në fuqi në prill të vitit 2018. Ky Protokoll standardizon dhe modernizon procedurën e importit, eksportit dhe transitit të mallrave në rajon, me shkëmbim elektronik dhe harmonizim të të dhënave dhe dokumenteve sipas modelit të BE-së. Përveç kësaj, me Protokoll prezantohet njohja e ndërsjellë e programeve, dokumenteve dhe rezultateve të doganave dhe kontrolleve të inspektimit midis nënshkruesve, dhe me këtë edhe midis Serbisë dhe Kosovës, bazuar në harmonizimin e arritur me rregullat dhe standardet e BE-së. Kjo praktikisht do të thotë që në rastin e mallrave të cilat importohen ose që hyjnë në transit, nënshkruesit e marrëveshjes CEFTA njohin inspektimet dhe dokumentet e kryera, me kusht që ligjet dhe procedurat e vendit importues të janë të harmonizuara me rregullat e BE-së. Në mënyrë që parimi për të cilin është pajtuar të bëhet operacional dhe që sektori privat të ketë përfitime konkrete nga njohja e ndërsjellë, është e nevojshme që vendet paraprakisht të pajtohen për procedurat për njohjen e statusit të harmonizimit të BE-së të cilin e miraton Komiteti i Përbashkët i CEFTA. Një procedurë e tillë për njohjen e programit dhe statusin të “subjektit të autorizuar ekonomik” u miratua në dhjetor të vitit 2019 në Tiranë, dhe deri më tani dy vendet nënshkruese (Maqedonia e Veriut dhe Serbia) kanë filluar procedurën e vlefshmërisë së programeve të tyre dhe realizimi i tij pritet menjëherë pasi të lejojnë kushtet vizitën e ekipit të vlerësimit. Vlerësimi i suksesshëm i programit nënkupton që të gjithë mbajtësit e statusit AEO për siguri të kenë trajtim të njëjtë nga të gjithë nënshkruesit, gjegjësisht në tregun rajonal, pa kontrolle shtesë ose kërkesa të tjera.

Pastaj, Protokollin shtesë 6 për liberalizimin e tregtisë me shërbime u miratua në dhjetor 2019 si një formë e rëndësishme e avancimit të bashkëpunimit dhe integritit rajonal, duke i mundësuar operatorëve ekonomikë që tregtojnë me shërbime që të operojnë në të gjitha vendet nënshkruese pa kufizime dhe kërkesa shtesë për njohjen e kualifikimeve profesionale, licencave specifike dhe standardeve tjera teknike, me kusht që ato të jenë të harmonizuara me rregulloret dhe standardet përkatëse të BE-së. Në mënyrë që parimi për të cilin janë marrë vesh të funksionalizohet dhe që sektori privat të ketë përfitime konkrete, është e nevojshme që paraprakisht të konfirmohet procedura për kontrollin e statusit të harmonizimit të BE-së, i cili është planifikuar për vitin 2020.

“Procesi i Berlinit” paraqet një iniciativë për të dinamizuar bashkëpunimin rajonal dhe dialogun politik të nivelit të lartë, i cili u fillua në vitin 2014, në njëqindvjetorin e shpërthimit të Luftës së Parë Botërore, dhe me iniciativën e Republikës Federale të Gjermanisë. Nisma ofron një platformë të rëndësishme për dialog midis liderëve të Ballkanit Perëndimor dhe Komisionit Evropian, Austrisë, Francës dhe Gjermanisë si vend nikoqir. Në këtë iniciativë janë bashkuar edhe Italia (organizoi samitin në Trieste në vitin 2017), Britania e Madhe (ishte

nikoqire e samitit në vitin 2018) dhe Polonia (nikoqire e samitit në vitin 2019). Me gjithë përfshirjen e një numri të vendeve anëtare të BE-së, në një përpjekje për të formuluar bashkërisht nisma dhe politika ndaj Ballkanit Perëndimor dhe kështu ta ndajnë edhe përgjegjësinë për zbatimin e tyre, fitohet përshtypja se Procesi i Berlinit mbetet përparësi për vendet që e iniciuan atë. Samiti, i cili do të organizohet para fundit të vitit 2020, do të organizohet bashkërisht nga Bullgaria dhe Maqedonia e Veriut për të siguruar një angazhim më të madh të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Gjithashtu, Serbia dikur kishte shprehur dëshirën e saj për të qenë vendi pritës i samitit të vitit 2018.

Aktivitetet me prioritet në kuadër të Procesit të Berlinit përfshijnë angazhimin në zgjidhjen e marrëdhënieve bilaterale dhe zhvillimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë në Ballkanin Perëndimor, luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar, dhe forcimin e institucioneve dhe sundimit të ligjit. Gjithashtu, theks i rëndësishëm u kushtua zhvillimit ekonomik dhe përshtypimit të rritjes ekonomike, mbështetje për përmirësimin e infrastrukturës dhe lidhjes energjetike në Ballkanin Perëndimor, në mënyrë që të sigurohet një parakusht për zhvillimin ekonomik dhe investime më të mëdha.

Gjithashtu, në kontekstin e Procesit të Berlinit, me iniciativën e Odave Ekonomike të Serbisë dhe Kosovës, u themelua WB6 CIF si një iniciativë e përbashkët e Odave Ekonomike nga vendet e Ballkanit Perëndimor i RYCO, e cila synon të promovojë shkëmbimin ndërkulturor të të rinjve në rajon. Gjithashtu, u nënshkrua Deklarata për Bashkëpunimin Rajonal dhe Zgjidhje të Kontesteve Bilaterale, e cila i dha përparësi pajtimit dhe zgjidhjes së çështjeve të hapura të mbetura në rajon.

Ekziston një numër i projekteve rajonale të transportit dhe energjisë, të cilat janë veçanërisht të rëndësishme për krijimin e kushteve për bashkëpunim më të mirë midis Serbisë dhe Kosovës, siç është ndërtimi i autostradës Nish-Prishtinë-Tiranë, gjegjësisht Deti i Zi-Deti Adriatik; modernizimi i hekurudhës Nish-Dolevac-Merdare-Prishtinë; elektrifikimi i trasesë hekurudhore 10 (Llapovë-Kralevë-Fushë Kosovë / Fushë Kosovë-Ferizaj / Ferizaj-Shkup; ripërtëritja e trafikut ajror, ndërtimi i ndërlidhësit të gazsjellësit midis Serbisë dhe Bullgarisë).

Përveç agjendës së lidhshmërisë, edhe përmirësimi i kornizës dhe harmonizimi i rregulloreve që rregullojnë bashkëpunimin ekonomik janë vendosur në qendër të Procesit të Berlinit. Në samitin në Trieste në vitin 2017, qeveritë e rajonit u angazhuan, me mbështetjen e BE-së, të punojnë për krijimin e një REA në Ballkanin Perëndimor, në të cilën mallrat, shërbimet dhe fuqia punëtore do të jenë në gjendje të lëvizin pa pengesa dhe e cila do të jetë një nxitje për investime, sepse do të mundësojë krijimin e një zone unike, një hapësirë ekonomike rajonale e cila bazohet në harmonizimin e kushteve dhe rregullave të afarizmit.

*Hapësira ekonomike rajonale* është një nga levat kyçe në procesin e integritit të Ballkanit Perëndimor për konsolidimin dhe integrimin më

të thellë të tregut rajonal. Në këtë drejtim, është dakorduar një Plani Shumëvjeçar i Veprimit për krijimin e një tregu rajonal ekonomik MAP-REA si një plan veprimi shumëvjeçar për krijimin e një hapësire ekonomike rajonale me më shumë se njëqind pikë në të cilat qeveritë u obliguan të ndryshojnë legjislacionet dhe aktet nënligjore, të përmirësojnë praktikat dhe të zbatojnë rregulloret të cilat rregullojnë lëvizjen e lirë të mallrave; modernizimin e vendkalimeve kufitare; njohjen e kualifikimeve profesionale dhe heqjen e pengesave për lëvizjen e studentëve, hulumtuesve dhe anëtarëve të komunitetit akademik dhe së fundi të punojnë në ndërtimin e një infrastrukture digjitale që përfshin uljen e shpenzimeve të romingut, vendosjen e internetit me brez të gjerë, dhe sigurimin e mbrojtjes së të dhënave dhe siguri kibernetike. E shikuar në tërësi, MAP-REA bazohet në katër shtylla të integritit: tregtia, investimet, lëvizshmëria dhe lidhja digjitale dhe zbatimi i saj që mbikëqyret nga RCC e krijuar për të koordinuar një agjendë gjithëpërfshirëse rajonale të lidhshmërisë.

*Katër Liritë / "Four Freedoms"* është një iniciativë e nisur në vitin 2019 për të promovuar bashkëpunimin ekonomik në Ballkanin Perëndimor përmes zbatimit të katër lirive themelore të tregut të përbashkët (liria e lëvizjes së njerëzve, mallrave, shërbimeve dhe kapitalit). Qëllimet kryesore të iniciativës janë përcaktuar përmes deklaratave nga Novi Sadi, Ohri dhe Tirana. Nisma u nis si një bashkëpunim trepalësh midis Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë, me një ftesë për ekonomitë e tjera të Ballkanit Perëndimor për t'u bashkuar. Janë përcaktuar fushat me prioritet të bashkëpunimit në rrugën e krijimit të një hapësire të përbashkët ekonomike përmes thellimit të bashkëpunimit dhe heqjes së pengesave që pengojnë valorizimin e potencialit të cilin e ofron tregu i përbashkët. Fushat me prioritet janë orientuar në krijimin e kushteve për lëvizjen e lirë të mallrave në rajon deri në vitin 2021; udhëtimi pa pasaportë midis tri vendeve; mundësia e marrjes së lejeve të punës dhe njohja e kualifikimeve pa formalitete shtesë. Theks i veçantë në deklaratë është vendosur në njohjen e ndërsjellë të kualifikimeve, shkëmbimin e studentëve dhe bashkëpunimin në projektet e përbashkëta hulumtuese dhe të zhvillimit. Po aq të rëndësishëm janë qëllimet specifike që merren me liberalizimin e investimeve dhe rrjedhën e kapitalit, me përshtatjet e nevojshme të legjislacionit me normat evropiane në këtë fushë.

Megjithëse kjo iniciativë në thelb integron angazhimet tashmë të bëra kryesisht nën marrëveshjen e CEFTA dhe Hapësirën Ekonomike Rajonale, ndryshe nga shumica e forumeve të tjera të bashkëpunimit të iniciuara dhe menaxhuara nga Bashkimi Evropian, kjo iniciativë është një përpjekje e liderëve të Ballkanit Perëndimor për të ndërmarrë përgjegjësi politike për hapat konkretë në zbatimin e reformave. Njëkohësisht, iniciativa është një përgjigje ndaj pakënaqësisë së arritur brenda kornizës ekzistuese të bashkëpunimit rajonal. Andaj, rëndësia e tij rrjedh nga domosdoshmëria për t'u forcuar dukshmëria politike

e iniciatorëve, për të ofruar mbështetje shtesë për zgjidhjen e problemeve specifike dhe pengesave për krijimin e bashkëpunimit më të thellë ekonomik rajonal, dhe për të përshpejtuar zbatimin e marrëveshjeve ekzistuese. Konkretisht, në takimin në Tiranë, Serbia pranoi që pa kushte të miratojë të gjitha marrëveshjet e pranuar më parë brenda CEFTA-s, miratimin zyrtar të cilave kishte kushtëzuar me heqje të taksës së Kosovës ndaj Serbisë. Më saktësisht, me pëlqimin e Serbisë, u krijuan parakushte për miratimin e Protokollit Shtesë 6 për Tregtinë në Shërbime, Procedurat e Validimit të Njohjes së AEO, Vendimin për Lehtësimin e Tregtisë me Pemë dhe Perime në Rajon, Strategjinë e Përbashkët dhe Planine Veprimit për Menaxhimin e Rrezikut Doganor në Rajon. Po ashtu, në dallim prej MAP-REA, e cila kishte deklaruar harmonizimin e kualifikimeve profesionale, si një nga masat me prioritet që nuk është zbatuar edhe pas katër vjetësh, nënshkruesit e nismës Katër Liritë janë angazhuar të harmonizojnë plotësisht legjislacionet e punës dhe atyre sociale dhe të sigurojnë sigurimin shëndetësor në mënyrë që plotësisht të hapin tregun e punës. Nëse zbatohen plotësisht, me njohjen automatike të titujve akademikë, këto masa do të sigurojnë në shumë pikëpamje lëvizshmërinë më të madhe të fuqisë punëtore dhe paraqesin një prej parandalimeve të mundshme të shkuarjes të fuqisë punëtore që të punojë jashtë rajonit.

Nëse edhe ekonomitë tjera të Ballkanit Perëndimor bashkohen me këtë iniciativë, atëherë ajo ka potencial të madh për të përdorur momentin e ri politik në procesin e integritimit rajonal, me një kontribut të rëndësishëm në përmirësimin e marrëdhënieve midis Serbisë dhe Kosovës. Ashtu si edhe nismat e tjera të mëparshme rajonale, edhe kjo do të jetë një test domethënës për ekzistencën e vullnetit politik që të arrihet afrimi dhe normalizimi i marrëdhënieve midis Serbisë dhe Kosovës, me pranimin e Kosovës si partnere të barabartë. Deri më tani, iniciativa është parë me një skepticizëm në Bosnje dhe Hercegovinë dhe Mal të Zi, ndërsa vetëm Kosova ka qenë vendosmërisht kundër hyrjes në këtë iniciativë.

Iniciativat rajonale bazohen në pikëpamjen se bashkëpunimi ekonomik dhe lidhshmëria kanë jehonë pozitive në ndërtimin e urave ekonomike, si dhe në ndryshimet politike dhe ndarjet. Nga kjo premisë pason lidhshmëria midis rritjes së bashkëpunimit ekonomik dhe stabilitetit politik, kështu që inkurajimi i lidhjeve komerciale dhe i bashkëpunimit afarist është thelbësor për normalizimin e marrëdhënieve midis Serbisë dhe Kosovës. Megjithatë, përvoja e deritanishme sugjeron që përfitimi ekonomik nuk është gjithmonë një motiv i mjaftueshëm ose mbizotërues të veprimit dhe sjelljes, pasi ka edhe variante tjera që funksionojnë në këtë marrëdhënie.

## Statusi i implementimit – shtrirjet dhe kufizimet

Duke analizuar rolin dhe rezultatet e iniciativave rajonale, përfundimi është se në Ballkanin Perëndimor, koha si burim zhvillimi nuk vlerësohet mjaftueshëm, pasi që asnjë ide ose projekt nuk realizohet sipas planit dhe me kohë. Ka vonesa të dukshme në zbatimin e planeve, kështu që përkundër marrëveshjeve të shumta për bashkëpunimin rajonal, ato ende nuk janë materializuar dhe janë larg nga dhënia e rezultateve më të rëndësishme.

Sidoqoftë, ekzistenca e iniciativave rajonale është padyshim e rëndësishme dhe e nevojshme. Ato janë provuar të jenë një mjet i suksesshëm për nxitjen e komunikimit dhe bashkëpunimit në rajon duke rritur ndërgjegjësimin për sfidat dhe qëllimet e përbashkëta. Gjithashtu, është bërë një hap i caktuar përpara në fusha të caktuara, megjithëse ndikimi i përgjithshëm i këtyre iniciativave në marrëdhëniet bilaterale midis Serbisë dhe Kosovës deri më tani ka dhënë vetëm rezultate të kufizuara konkrete. Fushat kryesore ku është bërë përparim shumë i kufizuar dhe ku mund të zbulohen devijime të konsiderueshme nga plani janë këto:

*Rrjedha i lirë i mallrave dhe shërbimeve:* Megjithëse ka pasur një shkallë të dukshme të liberalizimit të rrjedhës të mallrave, agjenda tregtare edhe më tutje mbetet e papërfunduar. Nevojiten përpjekje të konsiderueshme për të hequr barrierat e mbetura jo-doganore, për liberalizimin e tregtisë me shërbime dhe në zbatimin efektiv të marrëveshjes së CEFTA-s nga të gjithë nënshkruesit. Zbatimi i suksesshëm i marrëveshjes CEFTA është i ngarkuar me çështje të shumta të pazgjidhura, veçanërisht në marrëdhëniet midis Beogradit dhe Prishtinës. Vetë fakti që marrëveshja e CEFTA-s u nënshkrua nga UNMIK-u në emër të Kosovës, ndërsa në praktikë pjesëmarrja e UNMIK-ut ka arritur në minimum, në mënyrë thelbësore minon funksionimin e suksesshëm të Marrëveshjes. Për më tepër, zbatimi i Marrëveshjes shpesh pengohet nga zbatimi i të ashtuquajturave masave mbrojtëse nga ana e nënshkruesve, me të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë e shkelin Marrëveshjen, dëmtojnë besimin dhe frymën e bashkëpunimit. Situata u bë veçanërisht e vështirë dhe e komplikuar kur Kosova vendosi një taksë prej 100% për të gjitha mallrat e importuara nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina, dy vende që nuk e njohin pavarësinë e Kosovës. Kjo masë shkaktoi humbje dhe dëme të mëdha si për palët e përfshira, ashtu edhe për të gjithë rajonin, dhe u hoq vetëm pas pjesëmarrjes intensive dhe presionit nga bashkësia ndërkombëtare, kryesisht nga Shtetet e Bashkuara dhe BE. Sidoqoftë, masa kishte pasoja shumë më të gjera sesa efektet ekonomike, për shkak të humbjessë konsiderueshme të besimit dhe ndërlikimeve të mëtejshme të marrëdhënieve Beograd-Prishtinë.

Gjithashtu, zbatimi i gjertanishëm i planeve të përfshira me agjendën e MAP REA është shumë i ngadaltë, pa rezultate të dukshme dhe të konsiderueshme

për përfituesit e politikave të dakorduara, gjegjësisht për qytetarët dhe komunitetin e biznesit në rajon. Përjashtim është marrëveshja për uljen graduale të çmimeve të romingut për thirrjet në rajon dhe lëvizja rreth kalimit të prodhimëve me prioritet gjatë pandemisë Covid-19, të ashtuquajturat “Korridoret e gjelbra”. Realizimi i prioritetëve tjera nga katër shtyllat e MAP REA është bllokuar midis planifikimit joreal të qëllimeve, të cilat nuk kanë marrë parasysh nevojat dhe mundësitë reale të vendeve, dhe burokratizimin e aktivitetëve si zëvendësim për mungesën e vullnetit politik për të zbatuar masat për të cilat tashmë janë marrë vesh ose për të iniciuar ndryshimin e kornizës për t’u përshatur nevojave të shfrytëzuesve.

*Lëvizshmëria e fuqisë punëtore:* Mund të konstatohet njëfarë përparimi në përpjekjen për të lehtësuar lëvizjen ndërkufitare të profesionistëve me kualifikim të lartë dhe hulumtuesve si dhe në hapjen e negociatave për njohjen reciproke të kualifikimeve për profesione të caktuara. Mirëpo, reformat në këtë fushë po vonohen ndjeshëm pa ndonjë rezultat të dukshëm. Nevojiten përpjekje intensive dhe të koordinuara për të rritur lëvizshmërinë e burimeve njerëzore dhe bashkëpunimin midis vendeve në rajon përmes politikave, masave dhe instrumenteve të përbashkëta.

*Liberalizimi i investimeve dhe rrjedhësë kapitalit:* Përparim modest mund të vërehet në zbatimin e programit rajonal të reformave të investimeve që synojnë pozicionimin e rajonit si një destinacion unik i investimeve. Agjenda Rajonale e Reformës së Investimeve (RIRA) është përgatitur, Platforma Rajonale Online për Promovimin e Investimeve është nisur, por mungon zbatimi i reformave konkrete në lidhje me harmonizimin me BE-në dhe standardet ndërkombëtare të praktikës së mirë. Për më tepër, për të tërhequr investime cilësore dhe të konsiderueshme në rajon, është i nevojshëm funksionimi i tregut rajonal të kapitalit, përkatësisht tregut financiar si shtyllë kurrizore e integritit ekonomik. Mirëpo, ende nuk është bërë asnjë përparim në konsolidimin e tregut rajonal dhe nevojitet punë intensive në harmonizimin e politikave dhe nxitjeve për integrimin efektiv të tregut financiar.

*Lidhshmëria infrastrukturore:* Përparimi i deritanishëm në këtë fushë ka qenë mjaft simbolik dhe kryesisht i kufizuar në nënshkrimin e letrave të synimit dhe dakordimeve për planet dhe masat për të ndërtuar një rrjet funksional të infrastrukturës në fushat e transportit dhe energjisë. Një nga shembujt e realizimit jashtëzakonisht të ngadaltë është ndërtimi i një autostrade që do të lidhë Korridorin e Dhjetë në Serbi me Prishtinën përmes Merdares i emërtuar si një simbol i pajtimit dhe dëshirës për normalizim midis Beogradit dhe Prishtinës, dhe për këtë edhe është quajtur Autostrada e Paqes. Vlera e përgjithshme e ndërtimit të seksionit të parë midis Nishit (Meroshin) dhe Ploçnikut është 255 milion euro (rreth 35 km). Kontributi i BE-së është 40.6 milion euro në grante investimi dhe 7.4 milion euro në asistencë teknike. Këto grante plotësojnë huan e Bankës Evropiane të Investimeve në shumë prej 100



milion euro dhe të BERZH-it në shumë prej 80 milion euro, ndërsa Qeveria e Republikës së Serbisë ka ndarë 27 milion euro. Ndërtimi i seksionit të parë nuk ka filluar ende dhe punimet e para priten vetëm në fillim të vitit 2021, gati shtatë vjet pasi u paralajmërua iniciativa në samitin e Berlinit. Si pasojë, është e nevojshme të përshpejtohet në mënyrë të konsiderueshme zbatimi i planeve të konfirmuara që kanë ndikim vendimtar në integrimin dhe zhvillimin socio-ekonomik si të Serbisë dhe Kosovës, ashtuedhe të gjithë rajonit.

*Qeverisja dhe institucionet:* Ndërtimi i një mjedisi ligjor, rregullator dhe institucional për integrimin ekonomik të Ballkanit Perëndimor ende nuk ka lëvizur shumë. Pak përparim është bërë në fusha të caktuara, por të gjitha ekonomitë e Ballkanit Perëndimor vazhdojnë të luftojnë me korrupsionin e përhapur dhe të rrënjosur thellë, pasigurinë ligjore dhe të gjitha sfidat që ajo paraqet. Kapërcimi i këtyre sfidave kërkon reforma të gjera strukturore për të forcuar sundimin e ligjit, transparencën, rritjen e konkurrencës, në mënyrë që të krijojë një mjedis stimulues për bashkëpunimin afarist dhe të investimeve. Përparimi në këtë fushë është i nevojshëm për të arritur forma më të thella të bashkëpunimit midis Serbisë dhe Kosovës, po ashtu edhe të gjitha vendeve në rajon, sepse ai shkon dukshëm përtej masave të cilat aplikohen në kufi. Përndryshe, edhe projektet më të suksesshme të infrastrukturës nuk do të mjaftojnë për të lidhur këto ekonomi.

## Të kuptuarit e sfidave të implementimit

Sipas analizës së mëparshme, bashkëpunimi rajonal ka treguar një përparim, por niveli i arritur i integritimit ekonomik është akoma i ulët, larg planeve dhe pritjeve. Kjo konfirmohet nga rezultatet e hulumtimit të realizuar në terren brenda projektit. Realizimi i qëllimeve të përcaktuara përballet me një numër sfidash, ndër të cilat mbizotërojnë:

*Mungesa e vullnetit dhe besueshmërisë politike:* Arsyeja kryesore përse iniciativat e integritimit rajonal kanë arritur vetëm sukses të kufizuar mund të gjenden në dështimin e qeverive për të përmbushur angazhimet e bëra në kuadër të iniciativave rajonale. Është e qartë se ekziston një hendek i vërtetë midis qëllimeve të deklaruara dhe realitetit politik në terren. Mungesa e vullnetit politik për të zbatuar detyrimet për të cilat është dakorduar është e dukshme, pasi që vendet nuk tregojnë përkushtim dhe gatishmëri të mjaftueshme për të nënshtruar interesat politike afatshkurtra ndaj qëllimeve afatgjata, gjegjësisht t'i zbatojnë masat të cilat e tejkalojnë kohëzgjatjen e mandateve të tyre. Pikërisht mospërputhja dhe hendeku midis asaj që deklarohet dhe asaj që kryhet është një prizëm i rëndësishëm përmes të cilit mund të shihen sukseset e integritimit rajonal.

*Mungesa e përgjegjësisë në zbatimin e obligimeve:* Mosrespektimi i marrëveshjeve dhe detyrimeve të dakorduara nga nënshkruesit është një nga arsytet që ndikojnë në çrregullimet e shpeshta dhe të konsiderueshme në marrëdhëniet ekonomike dhe politike në rajon. Në këto rrethana, domosdoshmërisht ka nevojë për të futur disiplinë tregtare dhe kontroll legjitim në kornizën rregullatore rajonale, në mënyrë që të sigurohet një zgjidhje më efikase të mosmarrëveshjeve tregtare dhe pasojave të tyre politike. Andaj, krijimi i një mekanizmi efektiv për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve është një hap i domosdoshëm drejt arritjes së një sigurie dhe besimi më të madh midis vendeve.

*Mosharmonizimi i objektivave me nevojat reale dhe sfidat me të cilat përballen vendet dhe me afatin kohor për realizimin e tyre.* Për më tepër, objektivat shpesh përcaktohen në mënyrë të paqartë, të përcaktuara në nivelin e aktiviteteve dhe proceseve, gjë që e bën të vështirë matjen e efekteve të masave dhe kufizim përcaktimin objektiv të rezultateve. Në mënyrë që qëllimet e përcaktuara të jenë të qarta dhe realiste, është e nevojshme që procesi i planifikimit të jetë më gjithëpërfshirës, transparent dhe në një masë më të madhe të përfshijë të gjithë aktorët relevant, para se gjithash sektorët civilë dhe privatë. Integrimi i nevojave dhe interesave më të gjera duhet të merret parasysh gjatë planifikimit të qëllimeve konkrete, jo vetëm për të siguruar angazhim më të madh dhe zbatim të plotë të asaj për çka është dakorduar, por edhe për zhvillim të mbështetjes publike për programin e reformës, e cila është e nevojshme për të ndërtuar besimin dhe besueshmërinë në të gjitha nivelet.

*Dobësia e strukturave rajonale:* Ekziston një numër i konsiderueshëm i iniciativave rajonale me linjat e përputhura shpesh të paqarta, gjegjësisht ndarja e mandateve të tyre, me mungesë të mekanizmave të duhura për të siguruar mbikëqyrjen e zbatimit të obligimeve të marra. Në mungesë të një mekanizmi dhe autoriteti të tillë, ose veprimi të tij joadekuat, bashkëpunimi mbështetet vetëm në veprim vullnetar, i cili vepron vetëm kur interesat kombëtare janë të lidhura mirë me qëllimet e përbashkëta. Në këtë kontekst, mënyra në të cilën vendet anëtare të Procesit të Berlinit trajtojnë zbatimin e prioritetëve kontribuon në dinamikën e ngadaltë ose moszbatimin e objektivave. Gjegjësisht, gjatë samitit, i cili organizohet një herë në vit në nivelin më të lartë, temat e bashkëpunimit rajonal të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe integritetit në BE janë në rend të ditës. Nuk është ndërtuar një mekanizëm i duhur politik për të marrë përgjegjësinë për zbatimin e marrëveshjes as në nivelin e qeverive të rajonit, as në nivelin e aktorëve më të rëndësishëm në Procesin e Berlinit. U tregua se RCC nuk mund të marrë këtë rol sepse nuk ka kapacitet dhe përgjegjësi politike për të miratuar dhe zbatuar politika që i mbesin qeverive të rajonit dhe Bashkimit Evropian si një institucion i cili ka instrumente për të mbështetur realizimin e politikave të caktuara.

*Mungesa e nxitjeve të duhura:* Zbatimi i reformave kërkon burime të konsiderueshme, dhe efektet dhe përfitimet potenciale shpesh janë të pasigurta, të

vështira për tu përcaktuar, ose mund të priten vetëm në një periudhë të gjatë kohore. Në rrethana të tilla, afrimi në anëtarësim në BE po imponohet si arsye dominuese pse ekonomitë e Ballkanit Perëndimor po përfshihen në nisma rajonale. Mirëpo, promovimi i këtij qëllimi në një kohë kur pranimi në BE ende paraqet vetëm një perspektivë të largët, për ekonomitë e Ballkanit Perëndimor nuk mjafton një burim stimulues i veprimit, prandaj ka një mungesë entuziazmi për procesin e normalizimit midis Serbisë dhe Kosovës. Për më tepër, asimetria e marrëdhënieve të cilën BE ka për secilën prej ekonomive të Ballkanit Perëndimor minon kohezionin rajonal dhe përkushtimin e vendeve për të përmbushur objektivat rajonale. Në këtë kontekst, një plan i qartë dhe i besueshëm i anëtarësimit në BE mund të veprojë si një stimulim për të nxitur bashkëpunimin dhe proceset e reformës.

*Menaxhimi i jashtëm i iniciativave:* Një pasqyrë e iniciativave rajonale tregon se shumica e tyre janë iniciuar dhe udhëhequr nga BE, duke konfirmuar faktin se ekonomitë e Ballkanit Perëndimor ende nuk janë të pjekura mjaftueshëm për të organizuar rreth interesave të përbashkëta dhe politikës rajonale. Shikuar më gjerë, kur një iniciativë imponohet politikisht nga jashtë dhe nuk është domosdoshmërisht e rrënjosur në motivet dhe interesat kombëtare, perspektiva e saj është shpesh e diskutueshme. Në një kornizë të tillë, integrimi rajonal nuk perceptohet domosdoshmërisht si një vlerë apo nevojë e pandashme e rajonit, por si një detyrë e imponuar për të arritur disa qëllime tjera. Pikërisht ky perceptim është një sfidë thelbësore dhe arsyeja e konsekuencës dhe angazhimit të pamjaftueshëm të vendeve të përfshira, prandaj duhen përpjekje dhe investime të konsiderueshme në ngritjen e nivelit të informimit dhe kuptimin e përfitimeve të integritit rajonal.

Meqenëse zbatimi i reformave mbetet shumë prapa planeve, është e rëndësishme të shikohet efektiviteti i përgjithshëm i iniciativave të ndryshme përmes një prizmi - mospërputhjes në mes të qëllimeve të përcaktuara dhe zbatimit aktual, sepse progresi nuk mund të matet përmes marrjes së obligimeve, por me zbatimin e tyre të vazhdueshëm dhe me implementimin praktik. Mbi atë bazë duhet të konsiderohet dhe vlerësohet efekti i tyre i gjertanishëm në avancimin e bashkëpunimit ekonomik ndërmjet vendeve, gjegjësisht ndërmjet Serbisë dhe Kosovës.



## VII Rekomandimet

Në dy dekadat e fundit, marrëdhëniet midis Serbisë dhe Kosovës kanë qenë jashtëzakonisht komplekse dhe të ngarkuara me çështje të pazgjidhura të cilat po e vështirësojnë zhvillimin e tyre të përgjithshëm. Dialogu i Brukselit vendosi themelin për normalizimin e marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë dhe deri më tani ka përmirësuar ndjeshëm lirinë e lëvizjes dhe tregtisë. Por, edhe më tutje, nuk ka pasur një kthesë thelbësore drejt normalizimit të këtyre marrëdhënieve. Kjo është arsyeja pse është e rëndësishme të vazhdohet dhe forcohet procesi i filluar, me mbështetjen e BE-së dhe në bashkëpunim me SHBA.

Duke marrë parasysh se normalizimi politik dhe integrimi ekonomik shkojnë krah për krah, vëmendja më e madhe e mundshme duhet të përqendrohet në adresimin e pengesave kryesore për përparimin në sferën ekonomike. Por përgjegjësia më e madhe është te liderët politikë dhe vendimet e tyre, të cilat duhet të synojnë kryesisht normalizimin e marrëdhënieve dhe stabilizimin e situatës në Serbi dhe Kosovë. Përveç kësaj, një qasje më pragmatike është e nevojshme në zgjidhjen e pengesave ekzistuese për afarizmin dhe bashkëpunimin e përgjithshëm, duke propozuar projekte zhvillimi që mund të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të Serbisë, Kosovës dhe Ballkanit Perëndimor.

Roli i sektorit privat, gjegjësisht afaristëve, kompanive, odave ekonomike dhe shoqatave të afarizmit, është i domosdoshëm në arritjen e procesit të normalizimit dhe zhvillimit të përgjithshëm të Serbisë dhe Kosovës.

Rekomandimet e mëposhtme burojnë nga gjetjet e hulumtimit në terren dhe nga analiza e qëndrimeve të komunitetit afarist, përvojat e odave ekonomike në largimin e pengesave për bashkëpunimin ekonomik dhe në avancimin e bashkëpunimit rajonal ekonomik, ndërsa mbështetjen e gjejnë në qëllimin e përbashkët - anëtarësimin e Serbisë dhe Kosovës në BE.

## Rekomandimet nga fusha e bashkëpunimit rajonal

Forcimi i bashkëpunimit rajonal dhe normalizimi i marrëdhënieve janë procese të ndërlidhura dhe të kushtëzuara. Normalizimi i marrëdhënieve ndërmjet Serbisë dhe Kosovës kontribuon në eliminimin e pengesave të shumta në afarizëm, para se gjithash të atyre që kanë të bëjnë me rregulloret dhe standardet e pa harmonizuara, dhe harmonizimin e tyre me standardet e BE-së. Forcimi i bashkëpunimit rajonal relakson adresimin e sfidave politike dhe të tjera të cilat i imponon procesi i normalizimit.

Rekomandimet dhe masat e propozuara kryesisht janë drejtuar kah mbështetja për largimin e kufizimeve për bashkëpunimin afarist dhe krijimin e kushteve për zbatimin e plotë të detyrimeve të dakorduara si dhe të atyre të reja në bashkëpunimin rajonal, zbatimimi i të cilave avancojnë konkurrencën e këtyre ekonomive.

### *Masat me prioritet*

- Të merret parasysh *krijimi i ministrive për bashkëpunim rajonal në të gjitha qeveritë e Ballkanit Perëndimor, për të mundësuar një koordinim dhe zbatim më të mirë të politikave të rëndësishme për avancimin e bashkëpunimit rajonal.*
- Të shqyrtohet *zgjerimi dhe avancimi i marrëveshjes ekzistuese për tregtinë e lirë me qëllim të integritetit të instrumenteve dhe masave për të përmirësuar efikasitetin e marrëveshjes ekzistuese dhe përfshirjen e masave të cilat kanë të bëjnë me krijimin e një tregu unik në rajon, i cili krahas obligimit për lëvizje të lirë të mallrave dhe shërbimeve, do të integrohet në kornizën ligjore dhe dispozitat të cilat kanë të bëjnë me protokollin e lirë të njerëzve dhe kapitalit.*
- Të përkrahet që intensifikimi i integritetit ekonomik dhe të bashkëpunimit në Ballkanin Perëndimor të bazohet në parimet e *respektimit dhe barazisë*, gjegjësisht me respektimin e interesave të të gjitha palëve të përfshira në mënyrë që të sigurohen parakushtet për pranimin e të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor në *“Iniciativën e Katër Lirive”*.
- *Është i nevojshëm një rol aktiv i Bashkimit Evropian dhe shteteve anëtare që janë pjesë e Procesit të Berlinit me qëllim që të insistohet në zbatimin e plotë të projekteve me prioritet dhe të premtimeve të bëra.*

## Masat teknike dhe operative në kuadër të marrëveshjes CEFTA

- Zbatimi i Vendimit mbi Njohjen e Ndërsjellë të Operatorëve të Autorizuar Ekonomik, i cili tashmë është dakorduar në mënyrë që të mundësojë përfitime konkrete për kompanitë që mbajnë këtë status.
- Zbatimi i Vendimit për lehtësimin e tregtisë me pemë dhe perime në rajon, i cili tashmë është dakorduar.
- Krijimi dhe zbatimi i procedurave për njohjen reciproke të dokumenteve dhe rezultateve të kontrolleve të organeve të inspektimit të doganave dhe të organeve tjera.
- Implementimi i shkëmbimit elektronik të të dhënave dhe dokumenteve ndërmjet doganave dhe shërbimeve të inspektimit (me mbështetjen e platformës SEED +), duke mundësuar shkëmbimin elektronik të dokumenteve në fushat e certifikatave fitosanitare, shëndetësore dhe veterinarë.
- Njohja e ndërsjellë e certifikatave të sigurisë dhe cilësisë së produktit.
- Krijimi i një mekanizmi rajonal për zgjidhjen e kontesteve, duke lidhur Protokollin Shtesë 7.
- Kompletimi i zonës së grumbullimit të origjinës së produkteve midis BE, CEFTA, Mesdheut dhe Ballkanit Perëndimor (Zona e Tregtisë së Lirë Euro-Mesdhetare), duke krijuar kushte më të mira për investime dhe bashkëpunim të kompanive në prodhim dhe eksport.
- Forcimi i bashkëpunimit rajonal në fushën e infrastrukturës së cilësisë me qëllim të marrjes dhe zbatimit të standardeve të BE-së si dhe kërkesat teknike në tregun rajonal, duke bërë të mundur tregtinë e papenguar të mallrave teknike.
- Forcimi i bashkëpunimit rajonal në mbikëqyrjen e tregut me krijimin e një sistemi elektronik për shkëmbimin e informacionit për produktet e rrezikshme në rajon (duke ndjekur shembullin e modeleve RAPEX, ICSMS)
- Forcimi i bashkëpunimit në fushat e konkurrencës dhe ndihmës shtetërore, përfshirë bashkëpunimin e autoriteteve kompetente që rregullojnë këto fusha, duke krijuar parakushte për arritjen e një konkurrence të shëndetshme dhe të ndershme në tregun rajonal.
- Eliminimi i kërkesave dhe praktikave diskriminuese në fushat e prokurimit publik.
- Heqja e pengesave rregullatore për ofrimin e lirë të shërbimeve në tregun rajonal në përputhje me Protokollin Shtesë 6.
- Krijimi dhe zbatimi i procedurave për njohjen reciproke të kualifikimeve dhe licencave të nevojshme për ofrimin e shërbimeve në kushte të njëjta në të gjitha tregjet e rajonit.
- Avancimi i kushteve rregullatore për zhvillimin e një tregu unik rajonal të tregtisë elektronike.

- Bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes së pronës intelektuale në rajon si thelbësor për zhvillimin e produkteve, shërbimeve dhe teknologjive të reja, gjegjësisht për tërheqjen e investitorëve të huaj dhe të atyre vendas.

### *Masat teknike dhe operative në kuadër të Procesit të Berlinit*

- Të iniciohet zhvillimi i një *strategjie të përbashkët rajonale në fushën e energjisë*, veçanërisht në fushën e gjenerimit dhe transmetimit / tregtisë së energjisë elektrike, me theks në mbështetjen në burimet e veta për ta bërë rajonin energjetikisht më të qëndrueshëm dhe më të sigurt dhe më të qëndrueshëm për mjedisin, dhe në përputhje me politikën e BE-së mbi “Marrëveshjen e Re të Gjelbër” dhe të zbatimit të tij në Ballkanin Perëndimor.
- Të miratohet një *strategji për optimizimin e burimeve*, objekteve të prodhimit dhe për investime në objektet e prodhimit në nivelin rajonal.
- Të intensifikohet *standardizimi i punës në fushën e burimeve të ripërtëris-hme të energjisë në nivelin rajonal dhe në përputhje me praktikën e BE-së dhe me qëllim të tërheqjes së investimeve dhe arritjes së qëndrueshmërisë së energjisë në rajon*.
- Të sigurohet zbatimi urgjent dhe i *qëndrueshëm* i masave dhe aktiviteteve për të krijuar një *hapësirë unik të investimeve në rajon* me qëllim të rritjes së mundësitë së vëllimit të ekonomive, të përmirësohet konkurrenca, të zhvillohet tregu financiar dhe të përmirësohet lidhja infrastrukturore.

### *Masat tjera*

Të sigurohet rrjedha e shpejtë e mallrave duke vendosur *korridore të gjelbra midis BE-së dhe Ballkanit Perëndimor*, si një zgjidhje e përhershme derisa vendet e rajonit të hyjnë në BE. Koha e ndalimit të kamionëve në pikat kufitare dhe në zonat e kalimeve kufitare midis Ballkanit Perëndimor dhe BE (kalimet kufitare me Kroacinë dhe Hungarinë) e bën sektorin e transportit, si dhe sektorë të tjerë të ndërlidhur me të, shumë jo konkurrues dhe ndikon negativisht në mjedisin e investimeve në rajon.



## Rekomandimet në fushën e normalizimit të marrëdhënieve midis Serbisë dhe Kosovës

Përparimi efektiv dhe i qëndrueshëm në normalizimin e marrëdhënieve dhe përmirësimin e bashkëpunimit midis Serbisë dhe Kosovës është kusht për zhvillimin e tyre, por edhe për zhvillimin e gjithë Ballkanit Perëndimor.

Prandaj, është e nevojshme të sigurohet zbatimi i plotë dhe i qëndrueshëm i marrëveshjeve tashmë të arritura në Dialogun e Brukselit dhe të merren masat e nevojshme për normalizimin sa më të shpejtë dhe të qëndrueshëm të marrëdhënieve ekonomike dhe të përgjithshme midis Serbisë dhe Kosovës.

### *Masat me prioritet*

- Propozohet që të formohet një *Ekip i Përbashkët për Bashkëpunim Ekonomik në kuadër të dialogut politik* – i cili do të përbëhej nga persona me besim më të lartë të liderëve të delegacioneve negociuese dhe të BE-së, dhe të cilët së bashku do të zgjidhnin një ekip bashkëpunëtorësh. Ndër të tjera, ekipi do të merrej me propozimin e një agjende investimesh për Serbinë dhe Kosovën, e cila duhet të monitorojë dhe mbështesë përparimin në procesin e negociatave, në heqjen e pengesave dhe zgjidhjen e çështjeve të rëndësishme të hapura për përmirësimin e bashkëpunimit të biznesit.
- Një *rol aktiv i BE-së dhe të SHBA* është i nevojshëm në modernizimin dhe ndërtimin e infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore që lidh Serbinë dhe Kosovën duke krijuar një Këshill të Përbashkët të Projektit (ose Fondit) i cili do të ishte përbërë nga përfaqësues të Kosovës, Serbisë, BE-së, SHBA dhe institucioneve relevante financiare. Ky këshill do të kishte koordinuar punën e tij me Ekipin e Përbashkët të Bashkëpunimit Ekonomik.
- Kryerja e “faturave të pastra” mund të forcojë besimin, t’i lehtësojë marrëveshjet dhe të përmirësojë bashkëpunimin ekonomik, prandaj është e nevojshme të kryhet *shikimi në kërkesat e ndërsjella* për të krijuar një metodologji për zgjidhjen e kësaj çështje. Rekomandohet që kërkesat e ndërsjella, kur është e mundur, të zgjidhen përmes kompensimeve, apo përmes projekteve të reja të përbashkëta pa kushtëzuar zgjidhjen e çështjeve të pronës përmes negociatave për trashëgiminë.

- Është e nevojshme të merren në konsideratë mundësitë për *formimin e një mini-rajoni sipas modelit të Euro-regjionit*: Të punohet në inkurajimin e lidhjeve të interesave përmes rajonizimit dhe decentralizimit të hapësirës dhe burimeve duke shqyrtuar mundësitë të cilat ofrohen nga qasja brenda-rajonale sipas modelit të politikës rajonale brenda BE-së, gjegjësisht në përputhje me konceptin e të ashtuquajtur Euro-regjionit. Thelbi i një bashkëpunimi të tillë është inkurajimipër detektimin e sfidave dhe interesave të përbashkëta, gjegjësisht të specifikave dhe veçorive të komunave dhe zonave të veçanta dhe më së shpeshti të atyre kufitare, të cilat më së shpeshti ndajnë sfida të njëjta ose të ngjashme ekonomike, gjeografike, infrastrukturore dhe sfida të tjera.
- Të shqyrtohen mundësitë dhe parametrat për formimin e *dy mini rajoneve*: i pari do të ishte, Prokuple-Novı Pazar-Mitrovicë (Veri/Jug)-Pejë dhe, i dyti, Vranje-Gjilan-Kumanovë.  
Mini-euro-regjionet do të kishin statusin e duhur juridik dhe theme-luesit do të ishin nënshkruesit e jashtëm të cilët do të formonin Ekipin për hartimin e akteve juridike dhe statutare të këtyre mini-rajoneve. Formimi i mini-rajoneve përmes zbatimit të katër lirive themelore të tregut të përbashkët duhet të përshpejtojë proceset e zhvillimit në territoret që ato përfshijnë edhe atë, para se gjithash, duke inkurajuar kontakte të drejtpërdrejta midis njerëzve afaristë, dhe me mbështetje financiare dhe teknike të zhvillimit të infrastrukturës të bizneseve të vogla dhe të mesme, sidomos në bujqësi dhe fushën e shërbimeve. BE-ja duhet të mbështesë ndërtimin dhe zhvillimin e këtyre mini-rajoneve me fonde për bashkëpunim ndërkuftar të komuniteteve lokale, me fonde për mbështetje të Procesit të Berlinit dhe me fonde të tjera të përshtatshme siç është Fondi tashmë i themeluar për veriun e Kosovës.
- Është e nevojshme të vendoset *transparenca e dialogut në Bruksel dhe të procesit të normalizimit* me qëllim të informimit të qytetarëve në kohën e duhur. Gjithashtu, bazuar në këtë transparencë, është e nevojshme të sigurohet mbështetja politike e publikut, e cila është veçanërisht e rëndësishme për ndryshimet e nevojshme kushtetuese dhe ligjore.
- Të përshtaten *porositë dhe fjalimet publike*, para se gjithash të përfaqësuesve politikë të të dy palëve në dialogun e Brukselit dhe në procesin e normalizimit, të përgatitet publiku për pranimin e domosdoshmërisë dhe rëndësisë së arritjes së një marrëveshjeje për normalizimin gjithëpërfshirës të marrëdhënieve midis Serbisë dhe Kosovës;

## Masat teknike dhe operative

- *Është e nevojshme të ndërmerren masat për të forcuar lidhjet infrastrukturore përmes realizimit të projekteve me prioritet të cilat janë të rëndësishme për procesin e mëtejshëm të normalizimit, si më poshtë:*
  - Autostrada e Paqes Beograd - Prishtinë - Durrës: të përshpejtohet fillimi i ndërtimit të seksionit Nish – Plloçnik dhe në të njëjtën kohë të fillohet me hartimin dhe gjetjen e mënyrave të financimit të seksionit Plloçnik-Merdare-Prishtinë;
  - projektimi, rindërtimi i infrastrukturës hekurudhore në drejtimin Nish-Dolevac-Merdare-Prishtinë-Fushë Kosovë (rindërtimi i tunelit në Merdare, ngritja e kapacitetit mbajtës të hekurudhës nga 16 në 22 tonë përgjatë tërë seksionit dhe ndërtimi i hekurudhës e cila mungon në relacionin Podujevë-Fushë Kosovë), dhe
  - elektrifikimi dhe rindërtimi i hekurudhës në drejtim Llapovë-Kraljevë-Rashkë-Mitrovicë- Prishtinë-Fushë Kosovë-Shkup.
- Për një kohë sa më të shkurtë të zbatohen marrëveshjet mbi vendosjen e trafikut ajror dhe hekurudhor të cilat janë arritur me ndërmjetësimin e të dërguarit special të presidentit të Shteteve të Bashkuara për negociatat midis Serbisë dhe Kosovës.
- Vëmendje të posaçme duhet t'i kushtohet ndërtimit të besimit të ndërsjellë në fushën e prodhimit të energjisë (menaxhimit të prodhimit të energjisë elektrike dhe të liqenit artificial të Ujmanit) si dhe projekteve inovative në fushën e energjisë, si p.sh. ndërtimi i një termocentrali të kombinuar për energjinë diellore me përdorimin e baterive të litiumit.
- Të caktohen afate të qarta dhe realiste për vendosjen e trafikut postar.
- Të forcohen kapacitetet dhe të modernizohet rrjetit i transmetimit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.
- Rekomandohet avancimi i monitorimit të zbatimit dhe përputhshmërisë statistikore me një rol aktiv të sektorit privat në mënyrë që të monitorohet zbatimi dhe zhvillimi i analizave, të ndikimit në kohë të duhur dhe efektiv në zbatimin e marrëveshjes. Është e nevojshme që ndërvarësia ekonomike të përcillet me harmonizimin e statistikave zyrtare me standardet ndërkombëtare dhe rekomandimet e BE-së me qëllim që të sigurohen të dhëna të përputhshme në të dy komunitetet dhe të përcillet përparimi në mënyrë sistematike.
- Duhet të forcohet roli i Odave Ekonomike të Serbisë dhe Kosovës si partnerë të barabartë me qeveritë në ndërtimin e besimit dhe kapërcimin e “barrierave psikologjike” në bashkëpunimin ekonomik dhe inkurajimin dhe promovimin e “integritit nga poshtë-lart”.
- Rregullisht të rishikohet dhe të raportohet mbi problemet të cilat pengojnë bashkëpunimin dypalësh tregtar dhe ekonomik dhe të propozohen masa për adresimin e këtyre problemeve.

- Të harmonizohet dokumentacioni / certifikatat e mbetura për lëvizjen e papenguar të mallrave ndërmjet Serbisë dhe Kosovës: certifikatat veterinarë për mishin dhe prodhimet e mishit, si dhe për qumështin dhe prodhimet e qumështit.
- Të inkurajohet dialogu sektorial përmes bashkëpunimit dhe analizës së mundësive për të krijuar *prodhime të përbashkëta dhe investime të përbashkëta* ndërmjet kompanive nga Kosova dhe Serbia, duke lidhur zinxhirin e furnizimit, veçanërisht në fushën e prodhimeve bujqësore dhe ushqimore.
- Të merren masat e nevojshme për të *inkurajuar bashkëpunim më të gjerë dhe forcuar të partneritetit* midis komuniteteve përmes vendosjes së bashkëpunimit në arsim dhe shkencë, gjegjësisht midis komuniteteve akademike dhe institucioneve kërkimore të Serbisë dhe Kosovës, dhe të inkurajohen kërkimet e përbashkëta.
- Të vendoset *bashkëpunimin universitar midis Universitetit të Beogradit dhe Universitetit të Prishtinës përmes nënshkrimit të një marrëveshjeje për bashkëpunim që do të përfshinte formimin e programeve të përbashkëta të cilat janë në gjuhën angleze, gjë që do të mundësonte shkëmbimin e studentëve dhe stafit arsimor. Gjithashtu, studentëve do t'u mundësohet të mësojnë në gjuhën serbe gjegjësisht gjuhën shqipe.*
- Të merren masat e nevojshme për të *forcuar potencialin e investimeve të të dy ekonomive duke pasur parasysh rëndësinë e investimeve të huaja të drejtpërdrejta në zhvillimin e tyre, me theks të veçantë në industri dhe forcimin e rrjedhës të investimeve në zonat kufitare.*

## Rekomandimet të cilat veçanërisht kanë të bëjnë me Kosovën

- *Është e nevojshme të punohet në hartimin dhe zbatimin e një strategjie gjithëpërfshirëse të qëndrueshme për zhvillimin ekonomik të veriut të Kosovës dhe për bashkëpunimin e komunave brenda Kosovës dhe përtej kufirit.*
- Gjithashtu është e nevojshme të inkurajohen dhe të mbështeten përfaqësuesit e komunave nga veriu i Kosovës me bashkëpunimin e ekspertëve nga Beogradi, Prishtina dhe ekspertëve ndërkombëtarë dhe shoqëria civile, për të formuar grupe të përbashkëta pune për të hartuar një elaborat mbi problemet prioritare dhe zgjidhjet *në fushën e mbrojtjes së mjedisit, menaxhimit të mbeturinave dhe të furnizimit me ujë, si dhe një plan i aktiviteteve për zgjidhjen e problemeve të tjera. Këto grupe pune duhet,*

*nëse është e nevojshme, të përfshijnë përfaqësues të Mitrovicës Jugore, Vushtrrisë, Skenderajt, Rashkës, Tutinit, Novi Pazarit dhe Kralevës.*

- *Të ratifikohet Protokollin Shtesë 5 sa më shpejt të jetë e mundur në mënyrë që vendimet e miratuara dhe obligimet e dakorduara që kanë bazë ligjore në PSH5 të mund të zbatohen.*
- *Të ratifikohet Protokollin Shtesë 6 sa më shpejt të jetë e mundur si bazë ligjore për zbatimin e obligimeve të dakorduara në fushën e liberalizimit të shërbimeve në tregun rajonal.*

## Rekomandimet të cilat veçanërisht kanë të bëjnë me Serbinë

Qeveria dhe autoritetet e tjera kompetente duhet, në konsultim me përfaqësuesit e komunitetit afarist, të përcaktojnë masat për të adresuar çështjet e mëposhtme sa më shpejt të jetë e mundur:

- *Hapja e tregut serb për produktet nga Kosova*
- *Funksionimi i qarkullimit të pagesave, veçanërisht të ndryshohet praktika e gjertanishme në të cilën faturimi i mallrave kryhet në deviza, ndërsa inkasimi bëhet në dinarë, me ç' rast Banka Popullore e Serbisë konverton sipas kursit të këmbimit që rezulton me diferenca të mëdha të kursit të këmbimit e që ngarkojnë njerëzit afaristë dhe kompanitë.*
- *Bankat në Serbi nuk japin garanci në favor të kompanive vendase që bëjnë biznes me kompanitë në Kosovë prandaj është e nevojshme të miratohen zgjidhjet përkatëse ligjore dhe kështu të shfuqizohet Udhëzimi mbi kryerjen e përkohshme të transaksioneve të caktuara të pagesave në territorin e Republikës Federative të Jugosllavisë, nr. 11 i 12 marsit 2001.*
- *Pamundësia e plasmanit të prodhimeve me akcizë, të kushtëzuar që kjo të mos shënohet me pulla të detyrueshme të akcizës me mbishkrimin "Republika e Kosovës".*
- *Të mundësohet plasmani i prodhimeve me shenjen "Made in Kosova" në tregun serb.*
- *Çështja e transitit, veçanërisht mallrat me origjinë shtazore për të cilat lëshohet një vendim me kushte veterinarë - sanitare për transit të lëshuar nga Ministria e Bujqësisë - Drejtoria e Veterinarisë.*
- *Mosnjohja e dokumentacionit të lëshuar nga institucionet e Kosovës të nevojshëm për pjesëmarrjen e ndërmarrjeve të Kosovës në prokurimin publik në Serbi.*
- *Mosnjohja e tabelave me shenjen "RKS".*





[www.fer.org.rs](http://www.fer.org.rs)

ISSN 978-86-920703-3-4



9 788692 070334 >